

Raporti vjetor 2019

Raporti vjetor i Institutit të Statistikave

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e shkurtimeve	3
HYRJE	4
Funksionimi i INSTAT	4
Strategjia e zhvillimit të INSTAT	20
Sistemi Kombëtar Statistikor dhe Zbatimi i PSZ	26
Aksione të reja statistikore gjatë vitit 2019	38
Censi i Popullsisë dhe Banesave	Error! Bookmark not defined.
Cilësia e të dhënave	45
Komunikimi dhe Publikimet	45
Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimi Evropian	53
Burimet njerëzore dhe financiare	83
Zbatimi i rekomandimeve	91
Kontaktet e institucionit	101

Lista e shkurtimeve

AFP	Anketa e forcave të punës
AKP	Anketa e kostos së punës
ANR	Anketa e ndërmarrjeve të reja
ANJL	Anketa e njërive lokale
APC	Anketa post-census
ASN	Anketa strukturore e ndërmarrjeve
ATN	Anketa tremujore e ndërmarrjeve
BE	Bashkimi Evropian
CAP	Intervista me kompjuter
CATI	Intervista me telefon
CFCU	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EDP	Procedura e Deficit të Tejkualuar
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIS	Informacioni Gjeo-hapsinor
IÇK	Indeksi i çmimeve të konsumit
IÇP	Indeksi i çmimeve të prodhimit
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti Mbështetës para Pranimi në BE
ISCO	Klasifikimi i Profesioneve
KS	Këshilli i Statistikave
NVE	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
NJEF	Njësi ekonomike familjare
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SCB	Zyra e statistikave të Suedisë
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim
SKS	Sistemi Kombëtar Statistikor

HYRJE

Të dashur lexues,

Në emër të Institutit të Statistikave, kam kënaqësinë të paraqes përpara jush, Raportin Vjetor 2019, ku kemi synuar të paraqesim një pasqyrë të plotë dhe sa më të detajuar të aktiviteteve të INSTAT dhe Sistemit Kombëtar Statistikor.

Viti 2019 shënoi një tjetër vit plot risi dhe sfida për INSTAT, për rritjen e produkteve statistikore dhe për ofrimin e të dhënave të besueshme dhe të krahasueshme, të cilat synojnë të ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale të vendit. Në përmbushje të misionit të tij, për prodhimin e statistikave asnjëanëse, transparente dhe të përditësuar, INSTAT rriti numrin e produkteve statistikore, me 9 publikime të reja. Gjithashtu, INSTAT u bë pjesë e Sesionit të 50-të të Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara, ku ndau eksperiencën e Shqipërisë në përgatitjen e Raportit Vullnetar Kombëtar. Në Maj 2019 Shqipëria u pranua anëtare e Grupit të Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ngritje kapacitetesh, përfaqësuar nga INSTAT, roli i të cilit është të sigurojë si grup drejtim strategjik për proceset e zbatimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm si dhe monitorimin dhe raportimin statistikor. Gjatë vitit 2019, në kuadër të punës përgatitore për Censin e ardhshëm të Popullsisë e Banesave, INSTAT zhvilloi Pilotin e Censit në zona të përcaktuara, rezultatet e të cilit po analizohen, për të garantuar realizimin me sukses të këtij operacioni madhor.

Falë bashkëpunimit me botën akademike, INSTAT ka publikuar në format elektronik dhe letër , revistën shkencore “Kërkimi”, duke ofruar artikuj shkencorë dhe informativë për të gjithë lexuesit. Në kuadër të përmirësimit profesional dhe rritjes së komunikimit me grupet e ndryshme të përdoruesve, INSTAT është angazhuar në edukimin statistikor, qëllimi i të cilit është ofrimi i njohurive statistikore për jo-ekspertët e kësaj fushe.

INSTAT për matjen e impaktit të ngjarjeve të jashtzakonshme të ndodhura nga fatkeqësitë natyrore apo pandemitë, organizon aktivitete ad – hoc për tju ardhur në ndihmë hartuesve të politikave dhe përdoruesve me informacion statistikor. Kështu, si pasojë e tëmeteve që goditën vendin tonë vitin e kaluar, INSTAT kontribuoi me dy aktivitete statistikore ad-hoc, duke matur impaktin e dëmeve të tërmetit pranë familjeve dhe ndërmarrjeve në zonat më të prekura.

Gjatë vitit 2019, prodhuesit e statistikave zyrtare kanë realizuar 117 aktivitete statistikore të parashikuara në Planin Vjetor të miratuar nga Kuvendi, për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021, të ndarë përkatësisht 2 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 9 nga Banka e Shqipërisë dhe 106 nga INSTAT. Gjithashtu, për vitin 2019 INSTAT ka kryer edhe 185 aktiviteteve mbështetëse statistikore, të cilat lidhen me natyrën e administrimit të institucionit dhe rritjen e performancës së tij.

Për vitin 2020, INSTAT ka parashikuar të kryejë në total 293 aktivitete, ndër të cilat 215 janë aktivitete të vazhdueshme dhe 78 janë aktivitete të reja, të cilat kanë rreth 6,399 detyra sipas fazave të punës të pasqyruar në modelin standard të proceseve (Generic Standard Business Process Model); 137 janë aktivitete statistikore, që lidhen direkt me procesin e prodhimit statistikor dhe 156 aktivitete të tjera, të cilat lidhen me aspektin e sigurimit të burimeve njerëzore dhe financiare, bazës materiale dhe shërbimeve, administrimit të institucionit dhe rritjes së performancës institucionale. 15 aktivitete statistikore do të sigurojnë shtesën e treguesve të rinj në përputhje me parimet e cilësisë statistikore.

Situata e krijuar nga Covid-19 dhe politikat e shtetit shqiptar për përballimin e fatkeqësisë natyrore, detyroi INSTAT të rishikonte prioritetet dhe aktivitetet statistikore për tu realizuar këtë vit. Pezullimi i veprimtarive përgatitore për Censin e Popullsisë dhe Banesave, i cili ishte parashikuar të kryhej në tetor të këtij viti, e bën të pashmangshme shtyrjen e këtij aktiviteti madhor për një kohë tjetër, ashtu sic kanë vendosur edhe vendet e tjera të Evropës. Megjithatë, ne do të vazhdojmë kryerjen e aktiviteteve përgatitore për realizimin e Censit, si një nga projektet më madhore të institucionit dhe shtetit shqiptar. Këto aktivitete do të marrin për bazë gjetjet e Pilotit të Censit të vitit 2019 si edhe situatat e emergjencave të fundit që kanë ndodhur, siç janë tërmeti i Nëntorit të 2019 dhe Covid-19.

Nëpërmjet Censit, do të grumbullohen të dhëna të rëndësishme, do të sigurohen informacione kryesore mbi popullsinë dhe banesat, do të shikohen ndryshimet e popullsisë në dekadën e fundit, madhësia dhe struktura e familjeve, migracioni, arsimi, punësimi, paaftësia, kushtet e banimit, etj. Seti i madh i të dhënave që do të sigurohen nga ky Cens, do të jenë një burim i mirë informacioni për zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të ndryshme socio ekonomike, strategjive dhe planeve të zhvillimit në nivel kombëtar, lokal dhe sektorial. Gjithashtu, ato do të jenë dhe një burim i rëndësishëm për monitorimin e arritjeve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Së fundi, gjej rastin të falënderojë stafin e INSTAT për profesionalizmin e treguar gjatë vitit në arritjen e objektivave të institucionit.

Elsa Dhuli

Drejtor i Përgjithshëm në Detyrë i INSTAT

Instituti i Statistikave INSTAT

Misioni i INSTAT

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjëanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni i INSTAT


INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i Sistemit Kombëtar Statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikor.

INSTAT, si burimi kryesor i informacionit statistikor, u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje dhe kërkime, duke shpërndarë informacionin statistikor në të njëjtën kohë për të gjithë grupet e përdoruesve.

Gjithashtu, INSTAT ndihmon edhe komunitetin ndërkombëtar të interesuar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor të sigurt dhe të krahasueshëm.

Struktura e Institutit të Statistikave

Në fund të vitit 2019, gjendja faktike në INSTAT kishte 206 punonjës, nga të cilët 194 punonjës të shërbimit civil dhe 12 punonjës administrativ, si dhe 30 pozicione vakante.



Kuadri Rregullator për fushën e prodhimit të statistikave zyrtare

Veprimtaria e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-it si pjesë kryesore përbërëse e tij ushtrohet në përputhje me Ligjin Nr.17/2018 “Për statistikën zyrtare”, Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021 dhe Planin Vjetor 2019 për zbatimin e tij, miratuar përkatësisht me Vendimet e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017 dhe nr. 40/2019. Sistemi Kombëtar Statistikor mbështetet edhe në normat ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë sektoriale të prodhuesve të tjerë të statistikave zyrtare, çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale etj.

Në kuadrin rregullator të sistemit përfshihen edhe konventat e marrëveshjet e tjera me institucionet ndërkombëtare në interes të zhvillimit statistikor në vend, si dhe aktet komunitare të

BE-së në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Institucionet prodhuese të statistikave zyrtare në vend synojnë të përfshijnë standardet statistikore të përcaktuara vecanërisht në Rregulloren (KE) nr.223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009, “Mbi statistikave evropiane...”, ndryshuar me rregulloren (KE) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 prill 2015.

Instrumente të tjerë rregullatorë të veprimtarisë statistikore të SKS janë edhe marrëveshjet e mirëkuptimit, të nënshkruara nga INSTAT me institucionet që furnizojnë prodhuesit me të dhëna administrative si edhe institucionet që mbështesin kryerjen e aktiviteteve.

Vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e klasifikimeve statistikore janë gjithashtu pjesë e kornizës ligjore që siguron harmonizimin e emërtimeve dhe kodifikimeve të produkteve, mallrave e shërbimeve nga të gjitha institucionet publike, dhe, për rrjedhojë, edhe harmonizimin e definicioneve të tyre nga pikëpamja statistikore, në përputhje me klasifikimet statistikore ndërkombëtare.

a) Ligji nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij

Ligji nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare” u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në zbatim të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë në lidhje me forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe rritjen e pavarësisë profesionale të prodhuesve të statistikave zyrtare. Miratimi i ligjit u cilësoi nga partnerët ndërkombëtarë si hapi më i rëndësishëm në fushën e prodhimit statistikor për të garantuar cilësinë statistikore dhe përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për këto produkte. Me pozicionimin e INSTAT-it si institucion publik i pavarur, i cili raporton drejtpërdrejt në Kuvend, është mundësuar rritja e besueshmërisë së publikut në vlefshmërinë e statistikave të prodhuara si dhe bashkëpunimi profesional ndërmjet aktorëve të tjerë të Sistemit Kombëtar Statistikor.

Në zbatim të ligjit për statistikave zyrtare, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave dhe kanë miratuar aktet nënligjore të cilat rregullojnë më tej funksionimin e sistemit statistikor dhe organeve të përfshira në drejtimin e tij:

- i. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.11.2018 “Për miratimin e procedurave, të kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidatave për t’u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave”. Ky projektakt është nxjerrë në vijim të frymës së ligjit për të forcuar pavarësinë profesionale të organit drejtues të INSTAT. Ai përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që duhen ndjekur për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, duke ndjekur procedurën transparente dhe publike të përzgjedhjes së tij.

- ii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”. Vendimi është nxjerrë si pasojë e ndryshimit të natyrës së përfaqësimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Sipas kërkesave të ligjit, Këshilli i Statistikave duhet të përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si grupi i drejtpërdrejtë i interesuar për produktin statistikor. Në përbërje të tij janë përfshirë anëtarë përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, organet e vetëqeverisjes vendore, medias, botës akademike, shoqërisë civile.
- iii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 07.11.2018 “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën është organ i cili udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të cilat përpunojnë të dhëna administrative. Ky komision ka për detyrë të kryejë përditësimin, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare. Harmonizimi i nomenklaturës finalizohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të këtij komisioni.
- iv. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 19.06.2019 “Për llojet e shërbimeve statistikore që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve kundrejt tarifave të paracaktuara. Ky vendim është miratuar në mbështetje të pikës 2 të nenit 36 të ligjit për statistikën zyrtare, në vijim të rritjes së autonomisë së INSTAT-it në menaxhimin e të ardhurave që krijon gjatë shërbimeve statistikore të kryera përtej atyre të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Planin Vjetor për zbatimin e tij.
- v. Vendimi i Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave”. Për shkak të ligjit të ri për statistikën zyrtare, INSTAT ka ndryshuar statusin nga institucion qendror në varësi të ekzekutivit, në institucion publik të pavarur. Struktura organizative e institucioneve të pavarura rregullohet me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar.
- vi. Vendimet e Kuvendit nr. 75/2019, 76/2019, 77/2019, 78/2019, 79/2019, 80/2019 dhe 81/2019, datë 04.07.2019 për lirin ose emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Vendimet e Kuvendit mundësuan plotësimin e të gjitha vendeve vakante të Këshillit të Statistikave dhe funksionimin e plotë të tij. Referuar

ligjit për statistikat zyrtare, anëtarët e këshillit gëzojnë mandat 5-vjeçar me të drejtë përsëritje jo më shumë se një herë.

b) Programi i Statistikave Zyrtare

Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor të të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, për një hark kohor prej pesë vitesh. Programi është dokumenti kryesor mbi të cilën bazohen veprimtaritë e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare gjatë pesë viteve të ardhshme. Ai përcakton institucionet prodhuese të statistikave, njësitë që detyrohen të ofrojnë të dhënat administrative etj, metodologjinë e prodhimit dhe frekuencën e publikimit të tyre.

Programi respekton garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në legjislacionin për statistikat zyrtare, në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (*European Statistics Code of Practice*)¹ dhe parimet themelore të Kombeve të Bashkuara (*Fundamental principles*).

Programi aktual përfshin periudhën 2017-2021 dhe është miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021”.

c) Plani Vjetor për zbatimin e PSZ

Plani Vjetor për zbatimin e PSZ është dokument i cili përgatitet nga INSTAT në bashkëpunim me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare dhe miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë në zbatim të neneve 9 dhe 10 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”. Dokumenti shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore në përmbushje të objektivave strategjike dhe rezultatet e pritshme të parashikuara në PSZ.

Mbështetur në pikën 2 të nenit 9 të ligjit për statistikat zyrtare, INSTAT është përgjegjës për përgatitjen e Planit Vjetor në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor, për të planifikuar operacionet, burimet dhe rezultatet e pritshme të vitit

¹ <http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>

pasardhës si dhe për të përcaktuar përgjegjësitë e aktorëve institucionalë të përfshirë për sigurimin, mbledhjen, përpunimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Në tërësinë e tij, dokumenti paraqet aktivitetet statistikore që do të kryejnë prodhuesit e statistikave zyrtare (aktualisht janë INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë), sipas fushave përkatëse statistikore që mbulojnë, shoqëruar me afatet e zbatimit të tyre. Më tej, në të paraqiten institucionet që janë përgjegjëse për dhënien e informacionit statistikor dhe frekuencën e transmetimit të këtij informacioni. Me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e veprimtarive të parashikuara dhe parandalimi i pengesave të mundshme, dokumenti përmban edhe nivelin e risqeve të pritshme.

Veprimtaria statistikore zyrtare për vitin e raportimit, u mbështet në Vendimin e Kuvendit nr. 40/2019, datë 05.03.2019 “Për miratimin e Planit të Vitit 2019 zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021”.

ç) Memorandume mirëkuptimi

Për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, besueshmërisë së publikut në to dhe për t’iu përshtatur standardeve të reja të përcaktuara nga ligji për statistikat zyrtare, gjatë vitit 2019 INSTAT ka nënshkruar dhe përditësuar sipas kuadrit të ri ligjor disa marrëveshje mirëkuptimi me institucione të tjera të cilët mbajnë të dhëna administrative, përfshirë edhe institucione të tjera publike e private, bota akademike, etj. Nëpërmjet marrëveshjeve, palët janë dakordësuar për shkëmbimin e të dhënave që disponojnë, duke respektuar parimet e konfidencialitetit statistikor dhe kuadrin ligjor mbi të cilat e ushtrojnë veprimtarinë institucionet përkatëse. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve, palët kanë shprehur vullnetin për të zhvilluar aktivitete e projekte të përbashkëta për rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, përfshirjes së stafit në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit statistikor, etj. Marrëveshjet e nënshkruara me universitetet kanë për qëllim përfshirjen e kërkuesve shkencorë në proceset e prodhimit dhe përdorimit të statistikave zyrtare si dhe të studentëve për tu njohur me fushën statistikore si praktikantë. Për të siguruar zbatimin e duhur të marrëveshjeve, palët janë dakordësuar për ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës, të cilët jo vetëm do të kujdesen për zbatimin e saj, por edhe për të propozuar ide apo veprime të tjera në interes të përmirësimit të cilësisë statistikore. Lista e memorandumëve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet INSTAT dhe institucioneve të tjera është si vijon:

Tabela 3: Memorandume Mirëkuptimi

Nr.	Memorandume Mirëkuptimi	Data e nënshkrimit
Prodhues të statistikave zyrtare		
1	Banka e Shqipërisë	12.05.2008
2	Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.10.2016
Ofrues të të dhënave administrative / Përdorues		
3	Ministria e Punëve të Brendshme	11.11.2010
4	Ministria e Mbrojtjes	13.06.2017
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	31.03.2016
6	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	20.01.2017
7	Ministria e Kulturës	11.03.2015
8	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	02.06.2017
9	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	08.07.2014
10	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	11.03.2015
11	Qendra Kombëtare e Bisnesit	08.05.2017
12	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	11.04.2017
13	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	11.04.2017
14	Shërbimi Social Shtetëror	06.06.2017
15	Drejtoria e Policisë së Shtetit	05.09.2017
16	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	27.09.2017
17	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	13.10.2017
18	Agjencia Kombëtare Elektronike dhe Postare	14.12.2017
19	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	12.01.2018
20	Financial Supervisory Authority	29.12.2017
21	Autoriteti Mbikqyrës Financiar	22.11.2017
22	Agjencia e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor	16.09.2016
23	Instituti i Shëndetit Publik	26.04.2018
24	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	09.02.2018
Bota akademike / përdorues të tjerë		
25	Universiteti Luarasi	14.07.2016
26	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	14.04.2016
27	Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Ekonomisë	02.05.2017
28	Universiteti Bujqësor i Tiranës	25.05.2017
29	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Tiranës	20.03.2018
30	Kolegji Harvard	03.02.2018
31	Universiteti "Epoka"	
32	Universiteti Evropian i Tiranës	21.01.2019

Bazuar në aktivitetet e Planit Operacional, synohet që për vitin 2020 të nënshkruhen marrëveshje të tjera mirëkuptimi, si edhe të rishikohen ato ekzistuese, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional.

Memorandumet e reja që priten të nënshkruhen në 2020 janë:

1. Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë
2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit
4. Agjencia e Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore duhet të udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, të përafruara edhe nga legjislacioni shqiptar në vitin 2018.

Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane përcakton standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane, për të siguruar statistika cilësore dhe për të arritur besueshmërinë përdoruesve në to. Ai është ndërtuar mbi një përkufizim të përbashkët të cilësisë së Sistemit të Statistikave Evropiane (SSE) dhe shtrihet në të gjitha fushat e rëndësishme të mjedisit institucional, proceset e prodhimit të statistikave deri në publikimin e statistikave zyrtare evropiane. Parimet e statistikave zyrtare që përmban ky kod janë të përafruara edhe në ligjin për statistikat zyrtare përkatësisht në nenet 4 e 5 të tij. Synimi i përafrimit të këtyre standardeve mundëson zbatimin e duhur të PSZ nëpërmjet përmirësimit të proceseve të mbledhjes, përpunimit e publikimit të statistikave zyrtare dhe rritjen e imazhit në publik drejt besueshmërisë në statistikat zyrtare. Parimet e statistikave zyrtare janë si më poshtë:

- a) **"paanshmëria"**, që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit;
- b) **"besueshmëria"**, që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më mirë që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kriterëve shkencorë për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave;
- c) **"pavarësia profesionale"**, që i referohet personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloj grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore, në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor;
- ç) **"përkatësia"**, që është mbledhja e të dhënave që kufizohet në atë çfarë është e nevojshme për arritjen e rezultatit të kërkuar;

d) **"kosto-efektiviteti"**, që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar;

dh) **"konfidencialiteti statistikor"**, që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm;

e) **"transparenca"**, që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Organet e tjera sipas ligjit për statistikën zyrtare

a) Bordi Drejtues

Bordi Drejtues është organ i cili vepron brenda INSTAT-it dhe ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit, të propozojë planet për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave të tij si dhe ti propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it udhëzime e standarde të cilat sigurojnë zbatimin e parimeve statistikore nga Sistemi Kombëtar Statistikor. Detyrat specifike të bordit përcaktohen në nenin 20 të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare".

Bordi Drejtues përbëhet nga të gjithë nëpunësit civilë të INSTAT-it të cilët janë të paktën të nivelit të mesëm drejtues, duke iu referuar strukturës organizative të miratuar me vendimin e Kuvendit. Në interes të transparencës me publikun si dhe në përmbushje të rekomandimeve të *Peer Review*, veprimtaria e Bordit Drejtues është publikuar në faqen zyrtare të INSTAT-it.

Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2019, Bordi Drejtues ka zhvilluar tre mbledhje (dt. 29.01.2019; 15.02.2019; 08.04.2019) nëpërmjet të cilave janë miratuar ndryshimet në Rregulloren e funksionimit të bordit, Planin Operacional 2019 i INSTAT-it, Planin vjetor i rekrutimeve dhe Rregullorja për Dhomen e Sigurisë. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij, Bordi Drejtues ka diskutuar mbi ngritjen e strukturave të nevojshme për garantimin e konfidencialitetit statistikor, hartimin e strategjisë së marketingut të institucionit, projekt-planet buxhetore, projekt-Raportin Vjetor për tu paraqitur në Kuvend, përgatitjen e dokumentit "Politika e Revizionimit të Llogarive Kombëtare" si dhe mbi përgatitjen e Projekt-Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor.

Gjatë katërmujorit të dytë, janë zhvilluar dy mbledhje të bordit (23.05.2019 dhe 08.07.2019). Në këtë mbledhje, Bordi Drejtues ka miratuar amendimet në Kodin e Etikës së INSTAT, amendimet në Rregulloren e Brendshme të INSTAT-it si dhe Rregulloren “Politika për administrimin e databazës statistikore”. Aktet e miratuara janë produkt i zbatimit të kërkesave të reja të legjislacionit për statistikën zyrtare, strukturën e re organizative të INSTAT-it dhe rekomandimeve të Peer Review. Në mbledhjen e datës 8 Korrik, Bordi Drejtues ka zgjedhur Zëvendëskryetarin e ri të bordit. Gjithashtu, në këto mbledhje bordi ka diskutuar ecurinë e planit të punës për zbatimin e objektivave strategjike të zhvillimit dhe rekomandimeve të Kuvendit dhe Peer Review.

Në katërmujorin e tretë të vitit, Bordi Drejtues ka zhvilluar dy mbledhje (24.09.2012 dhe 26.11.2019). Në këto mbledhje ka diskutuar ngritjen e Komitetit të Cilësisë, Komitetit të Konfidencialitetit si dhe Grupin Teknik për Konfidencialitetin, organizma të cilat sigurojnë zbatimin e rekomandimeve të Peer Review për respektimin e parimit të konfidencialitetit statistikor. Më tej, në mbledhje bordi ka miratuar përmbajtjen e projekt-Planit Vjetor 2020 për zbatimin e PSZ, dokumenti i cili i përcillet Kuvendit për miratim nëpërmjet Këshillit të Ministrave si dhe ka miratuar amendimet në Rregulloren për Parandalimin e Konfliktit të Interesave.

Vendimet e Bordit Drejtues për vitin 2019

1. Vendimi nr. 7, datë 01.02.2019 “Për miratimin e Planit Operacional për vitin 2019”;
2. Vendimi nr. 8, datë 01.02.2019 “Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Bordit Drejtues, të miratuar me Vendimin nr. 1174/13, datë 29.11.2018”;
3. Vendimi nr. 1, datë 18.02.2019 “Për miratimin e planit vjetor të rekrutimeve për vitin 2019, sipas aneksit bashkëlidhur”;
4. Vendimi nr. 3, datë 10.04.2019 “Për miratimin e Rregulloreve të Dhomës së Sigurisë”;
5. Vendimi nr. 4, datë 24.05.2019 “Për miratimin e Kodit të Etikës”;
6. Vendimi nr. 5, datë 09.07.2019 “Për miratimin e Rregulloreve të Brendshme të INSTAT” dhe “Për miratimin e Rregulloreve “Politika për Administrimin e Databazës Statistikore”;
7. Vendimi nr. 208/19 prot., datë 09.07.2019 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 1174/2, datë 03.08.2018 “Për caktimin e zëvendëskryetarit të Bordit Drejtues”;

Përbërja e Bordit Drejtues 2019

1. Elsa Dhuli, Zëvendëskryetar i Bordit Drejtues;
2. Helda Mitre, Anëtare
3. Maldi Dema, Anëtar dhe anëtar mbikqyrës për Sekretariat;
5. Liliana Brahja, Anëtare
6. Ervin Shameti, Anëtar
7. Alma Kondi, Anëtar
8. Etugert Llazi, Anëtar
9. Elona Sevrani, Anëtare
10. Elton Alike, Anëtar
11. Majlinda Nesturi, Anëtare
12. Denis Kristo, Anëtar
13. Altin Xhikneli, Anëtar

Këshilli i Statistikave

Këshilli i Statistikave mbështet INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se Programi Statistikave Zyrtare është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikat zyrtare.

Këshilli i Statistikave përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit e statistikave zyrtare, botën akademike, shoqërinë civile dhe sipërmarrësit privatë, organet e vetëqeverisjes vendore dhe median.

Emërimi i anëtarëve bëhet me vendim të Kuvendit. Këshilli i Statistikave e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe VKM-në nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.

Këshilli i Statistikave mbledhet të paktën tri herë në një vit kalendarik. Kuorumi përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë të Këshillit. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i.

Gjatë vitit 2019, përbërja e Këshillit të Statistikave wshtw mandatuar me rritjen e numrit tw anwtarwve tw tij, nga 7 në 11 anëtarë, duke pwrmbushur kwshtu kwrkesat e ligjit tw ri pwr statistikat zyrtare.

Me Vendimin nr. 75/2019 “Për lirim nga detyra të një anëtari të KS dhe zëvendësimin e tij” të Kuvendit të Shqipërisë është liruar nga detyra Z. Ardian Kamenica, përfaqësues kryesor i statistikave zyrtare dhe në vend të tij është emëruar Znj. Oriana Arapi, përfaqësuese kryesore e statistikave zyrtare, për pjesën tjetër të mandatit.

Me Vendimet e Kuvendit nr. 76 – 81/2019 “Për emërimin e një anëtari të Këshillit të Statistikave” janë emëruar anëtarë të rinj të Këshillit të Statistikave: Z. Arbjan Mazniku, përfaqësues i organeve të qeverisjes vendore; Znj. Majlinda Dhuka, përfaqësuese e përdoruesve kryesore të statistikave zyrtare; Znj. Albana Çami, përfaqësuese e botës akademike; Znj. Eni Vasili, përfaqësuese e medias; Z. Endrit Iami, përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Ines Muçostepa, përfaqësuese e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë. Mandati për të gjithë anëtarët e rinj ka filluar më datë 04.07.2019.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 3 mbledhje përkatësisht të datave 15.07.2019, 31.10.2019 dhe 25.11.2019.

Çështje të shqyrtuara nga Këshilli i Statistikave në mbledhjen e parë të datës 15.07.2019 kanë përfshirë temat si: Prezantimi i anëtarëve të rinj të Këshillit të Statistikave; Prezantim i përgjithshëm i INSTAT; Rregullorja dhe funksionimi i Këshillit të Statistikave dhe detyrat e anëtarëve sipas ligjit; si dhe Draft kalendari i zhvillimit të mbledhjeve për vitin 2019;

Në mbledhjen e datës 31.10.2019 të Këshillit të Statistikave, janë diskutuar çështjet si: Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare Maj-Gusht 2019; Rregullorja e Brendshme për funksionimin e Këshillit të Statistikave; si dhe është paraqitur për sugjerime një material informues mbi fillimin e Censit Pilot;

Gjatë mbledhjes u miratua me vendim Rregullorja e brendshme për funksionimin e Këshillit të Statistikave. Kjo rregullore ka për objekt rregullimin në mënyrë të detajuar të marrëdhënieve të

anëtarëve të Këshillit të Statistikave, mënyrës së dokumentimit të mbledhjeve si dhe përcaktimin e komunikimit ndërmjet anëtarëve të Këshillit me administratën e INSTAT

Në datën 25.11.2019 është zhvilluar mbledhja e fundit për vitin 2019 e Këshillit të Statistikave, në të cilën u kaluan për diskutim çështjet sipas rendit të ditës : Zgjedhja e Zv. Kryetarit të Këshillit të Statistikave; Planit vjetor 2020 i Programit të Statistikave Zyrtare; si dhe u diskutua mbi draftin e përgatitur të Strategjisë së zhvillimit të Sistemit Statistikor Kombëtar 2020-2030;

Sipas Planit vjetor numri aktiviteteve statistikore që do të zbatohen në total është 143 aktivitete të cilat ndahen sipas agjencive statistikore: INSTAT 131 aktivitete statistikore; Banka e Shqipërisë 10 aktivitete statistikore; si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë 2 aktivitete statistikore.

Hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor (SZHSKS) 2018-2030 është ndërmarrë në kontekstin e: mbështetjes së fuqishme nga qeveria shqiptare për zhvillimin statistikor; procesin e transformimit drejt integritit në Bashkimin Evropian (BE); zbatimit të rekomandimeve të BE-së për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në Shqipëri sipas *acquis communautaire* (*acquis*) për statistikat; rritjen e vazhdueshme të kërkesës për sasi më të mëdha dhe cilësi të dhënash nga përdoruesit në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar për qëllime politikash, planifikimi dhe monitorimi; ndryshimeve të shpejta në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për statistikat dhe Ligjit të ri Nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, miratuar në 5 prill 2018.

Etika e institucionit dhe e Titullarit

Në kryerjen e funksioneve të tij publike titullari, por dhe çdo punonjës i institucionit e bazon aktivitetin në përputhje me parimet e etikës së shëndoshë të diktuar nga ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Për zbatimin e standardeve të etikës institucionale, INSTAT ka miratuar Kodin e Etikës, me Vendimin nr. 390 prot., datë 13.03.2017. Rregullorja e Brendshme e INSTAT përmban gjithashtu kapitull të vecantë për normat e etikës në institucion dhe mënyrat e trajtimit të rasteve të shkeljes së saj.

Vitin e kaluar është evidentuar vetëm një rast për shkeljen e etikës profesionale e cila bie në kundërshtim me normat e Kodit të Etikës së institucionit dhe Rregullores së Brendshme të tij. Bazuar në këto akte, si dhe legjislacionin në fuqi, INSTAT ka marrë masat e duhura për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Nuk është paraqitur ankesë ndaj vendimmarrjes.

Struktura Mbikqyrëse e Etikës

Struktura Mbikqyrëse e Etikës përcaktohet me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm. Në përbërje të saj, dhe sipas hierarkisë, është Përgjegjësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i Financës dhe Projekteve. Kjo strukturë i raporton Drejtorit të Përgjithshëm rast pas rasti, por dhe në mënyrë periodike, rastet e konstatuara në shkelje të Kodit të Etikës. Në bazë të raportimeve, ajo fillon procedurën disiplinore në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi. Procedura mund të fillojë edhe kryesisht.

Çdo punonjës i institucionit është i detyruar të bashkëpunojë dhe të raportojë pranë kësaj Strukturës Mbikqyrëse të Etikës. Për çdo rast të raportuar, apo të filluar kryesisht, Struktura Mbikqyrëse e Etikës duhet të përpilojë një raport të posaçëm të cilin ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm në formën e njoftimit apo të propozimit për marrje masë disiplinore.

Strategjia e zhvillimit të INSTAT

Strategjia e zhvillimit të INSTAT 2017-2030, është hartuar duke marrë në konsideratë objektivat strategjike kombëtare dhe sektoriale zhvillimore për periudhën afat-mesme dhe afatgjatë, për të përmbushur kërkesat gjithnjë e në rritje të përdoruesve për statistika cilësore. Strategjia përmban 4 objektiva kryesorë të cilët kanë të bëjnë me zhvillimin e cilësisë statistikore, përdorimin e burimeve të informacionit, përmirësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve profesionale të SKS si dhe zhvillimin e infrastrukturës së prodhimit statistikor. Objektivat strategjike afatgjatë të institucionit janë hartuar gjithashtu edhe në përputhje me ato të parashikuara në PSZ 2017-2021, për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor. Me qëllim arritjen e këtyre objektivave, INSTAT ka hartuar gjithashtu edhe një plan veprimi afatmesëm (2017-2020), i cili përmban një sërë nënobjektivash dhe aktiviteteve konkrete, si dhe përcakton përgjegjësitë e njësive strukturore të institucionit për përmbushjen e tyre. Aktivitetet në frekuencë vjetore përfshihen në Planin Operacional të INSTAT-it.

Në vijim paraqitet informacioni mbi veprimtarinë e INSTAT, gjatë vitit 2019 dhe synimet për vitin 2020, në interes të përmbushjes së 4 objektivave strategjike madhorë përkatësisht:

Objektivi 1: Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.

Objektivi ndikon drejtpërdrejtë në plotësimin e pritshmërive të përdoruesve për statistika zyrtare për qëllime vendimmarrje, politikëbërje, kërkimore-shkencore apo orientuese, si dhe në besueshmërinë e publikut në cilësinë e statistikave të prodhuara.

Gjatë vitit 2019, numri i publikimeve të INSTAT shkoj në 160 nga të cilët 9 ishin publikime të reja, krahasuar me vitin 2018 që ishin 159 publikime. INSTAT ka shtuar prezencën në media lidhur me transmetimin e të dhënave të prodhuara dhe kuptueshmërinë e produkteve statistikore. Për vitin 2020 INSTAT do të fokusohet në përmbushjen e këtij objektiwi nëpërmjet mbulimit më të mirë me informacion statistikor dhe në shtimin e numrit të treguesve në fusha të ndryshme statistikore. Gjatë vitit do të kryhen përmirësime metodologjike në përputhje me metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, me qëllim që të rritet imazhi dhe thjeshtësohet akses i publikut në informacionin statistikor, INSTAT do të punojë për zbatimin e sistemit për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë së proceseve statistikore si dhe do të pasurojë me të dhëna faqen web të tij.

Për ti qëndruar më pranë përdoruesve dhe për të tërhequr të interesuarit nga bota akademike, në vitin 2018 INSTAT ka publikuar edhe Revistën me karakter shkencor “Kërkimi”. Revista, e

pajisur edhe me kodin ISSN, përmban artikuj shkencorë dhe informativë mbi proceset e aplikuara për prodhimin statistikor, risitë dhe zhvillimet përmirësuese të këtyre proceseve. Në vitin 2019 janë botuar dy numra të kësaj reviste, ndërkohë për vitin 2020, INSTAT parashikon grupimin e artikujve të karakterit informativ në një revistë me emërtim tjetër, në mënyrë që revista “Kërkimi” të ruajë natyrën e vet shkencore.

Një aspekt tjetër ku INSTAT është fokusuar për përmbushjen e kërkesave statistikore, për vitin 2019 ka qenë edhe prodhimi i statistikave zyrtare në nivel vendor. Në fund të vitit, në praninë e përfaqësuesve të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, është organizuar edhe një konferencë ku INSTAT ka prezantuar produktin “Vjetari Statistikor Rajonal” i cili përmban informacione për bashkitë sipas ndarjes së re territoriale.

Objektivi 2: Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.

Rritja e burimeve të të dhënave administrative ndikon drejtpërdrejtë jo vetëm në koherencën dhe cilësinë e produktit statistikor, por edhe në reduktimin e kostove për sigurimin e këtyre të dhënave. Agjencitë statistikore dhe institucionet e tjera publike, për ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e natyrës së punës që kanë, mbledhin të dhëna të cilat mund të përdoren edhe për qëllime statistikore zyrtare. Gjatë vitit 2019, në kuadrin e përgatitjes së Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, INSTAT ka arritur të hartojë një listë të institucioneve që disponojnë të dhëna të cilat mund të jenë të vlefshme për rritjen e gamës së statistikave zyrtare. Megjithatë, një inventarizim më i mirë i këtyre seteve do të bëhet gjatë punës përgatitore të Programit të ri të Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Ndërkohë, INSTAT ka intensifikuar marrëdhëniet me këto institucione nëpërmjet formalizimit të marrëveshjeve, ngritjes së grupeve të përbashkëta të punës si dhe përcaktimit të infrastrukturës teknologjike për transmetimin e të dhënave.

Për vitin 2020, INSTAT i jep rëndësi të veçantë testimit të mënyrave të reja të mbledhjes së të dhënave. Konkretisht, parashikohet që të kryhet testimi i mbledhjes së të dhënave nëpërmjet përdorimit të tabletëve (p.sh. për anketat ATN dhe IÇK) si dhe mbledhja e të dhënave Web në lidhje me vërtetimin për Mbetjet e Ngurta Urbane. Metoda CAPI do të përdoret në 7 Anketa gjithsej, në 5 prej tyre ky proces përdoret periodikisht, ndërsa për 2 prej tyre do të jetë pilotim mbledhja e të dhënave me këtë metodë.

Sigurimi i të dhënave administrative mikro nëpërmjet një pike hyrëse të vetme në INSTAT, do të ndikojë në përdorimin dhe përpunimin më eficient të të dhënave administrative të marra.

Integrimi i informacionit gjeohapsinor me informacionin statistikor do të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e statistikave zyrtare nëpërmjet: i) Përditësimit të vazhdueshëm të planifikuar të informacionit. ii) Lidhjes së GIS me treguesit statistikorë dhe regjistrat. iii) Rritjes së numrit të burimeve të informacionit për përditësimin e GIS. iv) Rritjes së përdorimit dhe shpërndarjes së informacionit statistikor gjeohapsinor.

Objektivi 3: Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.

Në vitin 2019 INSTAT është përqendruar në përmirësimin e komunikimit ndërmjet prodhuesve të statistikave zyrtare me qëllim që të krijohet infrastruktura e duhur për koordinimin e sistemit. Pas komunikimeve të shumta, u arrit draftimi i projekt-urdhërit të përbashkët ndërmjet prodhuesve për ngritjen e Komitetit të Prodhuesve. Për detyrat konkrete të komitetit, Eurostat ka dhënë në fund të vitit të kaluar sugjerimet përkatëse të cilat janë reflektuar në projektdokument. Përsa i takon rritjes së kapaciteteve profesionale të punonjësve të sistemit, nëpërmjet Qendrës së Trajnimit të krijuar vitin e kaluar, INSTAT ka mundur zhvillimin e disa trajnimeve për statisticienët.

Në vijim të përpjekjeve për përmirësimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, për vitin 2020 INSTAT synon të forcojë bashkëpunimin e institucionet furnizuese me të dhëna administrative, si burimi kryesor i cili ndikon drejtpërdrejt në cilësinë statistikore dhe gamën e statistikave zyrtare. Gjithashtu, në vitin 2020 do të finalizohet ngritja e Komitetit të Prodhuesve të statistikave zyrtare, proces i cili ka nisur vitin e kaluar duke konkluduar me përgatitjen e një projekt-urdhëri të përbashkët ndërmjet INSTAT, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Komiteti i Prodhuesve është mekanizëm i rëndësishëm për cilësinë e proceseve të planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore dhe ngrihet në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit dhe Eurostat. Në drejtim të ngritjes profesionale dhe përmirësimit të performancës së sistemit, gjatë vitit 2020 do të vijojë forcimi i bashkëpunimit me botën akademike si faktor i rëndësishëm që ndihmon në përmirësimin e standardeve të prodhimit e përdorimit të statistikave zyrtare në fushën kërkimore-shkencore. Grupi me Botën Akademike, i cili është krijuar dhe ka zhvilluar tashmë mbledhjen e parë të tij, do të propozojë hapat konkretë në këtë drejtim.

Qendra e Trajnimit Statistikor, e cila tashmë ka infrastrukturën e plotë të funksionimit, do të ndikojë pozitivisht në rritjen e kapaciteteve profesionale të statisticienëve dhe nga ana tjetër, në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike, do të ftojë në proceset e përpunimit e prodhimit edhe grupet e tjera të interesuara, si media, studentë, politikëbërës, studiues etj. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2020 do të organizohen trajnime e workshope të ndryshme si për statisticienët, ashtu dhe për të interesuarit e këtyre grupeve.

Objektivi 4: Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

Me qëllim përmbushjen e këtij objekti, INSTAT do të vazhdojë angazhimin e tij në lidhje me modernizimin e mbledhjes së të dhënave dhe proceseve prodhuese të statistikave. Zhvillimi dhe përdorimi i një sistemi qendror të integruar të Teknologjisë së Informacionit për menaxhimin e të dhënave dhe metadata-ve, që do të mundësojë punën sinergjike, do të jetë një sfidë për INSTAT në vitet në vijim. Për të siguruar që elementet e proceseve prodhuese të përmbushin standardet e kërkuara të cilësisë, INSTAT do të përqendrohet në zhvillimin e sistemeve për menaxhimin e cilësisë, veçanërisht duke u fokusuar në auditimet e brendshme të cilësisë dhe metodologjinë e përdorur për matjen e indikatorëve. Ndër aktivitetet kryesore për vitin 2020, mund të përmenden pilotimi i sistemit online për aksesimin e të dhënave nga kërkuesit shkencorë si edhe pilotimi dhe përdorimi i teknikave elektronike të mbledhjes së të dhënave për aktivitetet statistikore që nuk i kanë përdorur me parë këto teknika.

Të gjithë publikimet e INSTAT gjatë vitit 2019, janë standardizuar duke përmbajtur elementë vizualë unikë që evidentojnë qartë “brandin” e markës. Publikimet sistematike, si njoftimet për media janë të gjitha të unifikuara dhe njihen publikisht si të INSTAT. Ndërkohë për publikimet “libra”, janë kryer përmirësime vizuale duke shtuar infografikë të dedikuara për botime të reja apo dhe ato që kanë patur janë shtuar dhe përmirësuar.

Sfidat për 2020

Për arritjen e objektivave strategjike dhe zbatimin me sukses të aktiviteteve statistikore në tërësi sfidat kryesore për vitin 2020 parashikohet të jenë:

1. Kultura e ndryshimit dhe e zhvillimit: INSTAT do të përdorë instrumente komunikimi dhe motivimi tek punonjësit në mënyrë që të rritet ndërgjegjja për zhvillim dhe inovacion, e cila synon të arrihet nëpërmjet angazhimit të INSTAT me artikuj shkencorë cilësorë në revistën Shkencore Kërkimi, revistën informative si edhe rritjen e edukimit statistikor nëpërmjet hartimit të një strategjie drejtuar grupeve të përdoruesve, zhvillimit të takimeve shpjeguese e informuese me studentët si dhe prezantimit të materialeve statistikore në kurrikulat mësimore për nxënësit e shkollave fillore e të mesme.

2. Politika dhe strategji efikase: INSTAT do të ndërtojë standarde duke aplikuar rregullore, udhëzime, manuale dhe stimuj të tjerë formalë që të drejtojnë institucionin drejt arritjes së objektivave strategjike, e cila synon të arrihet nëpërmjet zbatimit të rregulloreve, udhëzimeve dhe manualeve të BE-së.

3. Niveli organizativ e institucional: INSTAT do të punojë për ndërtimin e sistemeve menaxheriale adekuate, ndërveprimin vertikal dhe horizontal ndërmjet sektorëve për arritjen e qëllimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata duke përdorur në mënyrën më të mundshme burimet që disponon institucioni, nëpërmjet prodhimit dhe monitorimit të indikatorëve që shërbejnë për matjen e Performancës së Indikatorëve PAF.

4. Komunikimi me përdoruesit: Përdoruesit e statistikave zyrtare janë klientela e produkteve të siguruara nga INSTAT. Institucioni do të punojë për t'iu përafruar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare, e cila synon të arrihet nëpërmjet rritjes së edukimit statistikor dhe organizimit të takimeve formale e informale me përfaqësuesit e medias.

5. Sigurimi i Vazhdueshmërisë: Fatkeqësitë natyrore që ndodhën në vendin tonë dhe më gjerë kanë impaktuar edhe vazhdueshmërinë e punës së përpunimit dhe publikimit statistikor. Për këtë arsye, INSTAT do të fokusohet në marrjen e masave konkrete për të reduktuar riskun e veprimtarisë statistikore dhe përdorimin e metodave të reja shkencore për fazat e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave. Për treguesit që tërheqin interes më të gjerë tek përdoruesit, INSTAT planifikon veprimtari shtesë në mënyrë që të prodhohen statistika orientuese eksperimentale (edhe pse jozyrtare për shkak të metodologjive të ndryshme të aplikuara).

Indikatorët e performancës

Korniza për vlerësimin e performancës institucionale ka për qëllim të kontribuojë në monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e eficiencës së veprimtarive që kryen institucioni. INSTAT e ka ndërtuar këtë kornizë duke identifikuar indikatorët e duhur që lidhen me aspektet kryesore strategjike dhe menaxheriale të tij, përfshirë edhe standartizimin e proceseve statistikore të cilat rrisin cilësinë e produktit statistikor. Gjithashtu, në kornizë janë përfshirë edhe indikatorë të cilët lidhen me përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për produktet statistikore koherente dhe cilësore. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe krahasueshmëria me vendet e tjera në rajon dhe Evropë.

INSTAT për të matur performancën e punës së tij në drejtim të planifikimit të aktiviteteve statistikore, monitorimit dhe raportimin e eficiencës së tyre ka përcaktuar 13 tregues për vitin 2020, nga 7 që ishin në vitin 2019. Në tabelën në vijim janë paraqitur indikatorët e vlerësimit të performancës për vitin 2019.

Tabela 1: Indikatorët e performancës për vitin 2019 dhe niveli i arritjes

Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM	↗	25%
Numri i publikimeve të reja	↗	2.5%
Numri i publikimeve në kohë - online	↘	78.5%
Numri i aktiviteteve statistikore që kanë përmirësim në afat		9
Data points në Eurostat data base për Shqipërinë ²		
Numri i vizitave në ëeb site	↗	49.13%
Numri i raporteve të cilësisë	↗	42.9%
Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve	↗	1,1 pikë përqindje
Numri i vrojtimeve pranë familjeve dhe NjEF e intervistuar	↗	4 vrojtime dhe 22.168 NjEF
Numri i vrojtimeve pranë ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjet e intervistuar	↘	1.382 Ndërmarrje Ndërmarrje
Kohëzgjatja e intervistës për anketat pranë familje mesatarisht	↘	10.86 minuta
Kohëzgjatja e intervistës për anketat pranë ndërmarrjeve është mesatarisht	↘	0,19 minuta
Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM	60 aktivitete të dokumentuara nga synimi 60 aktivitete	
Numri i vlerësimeve statistikore të kryera		2

² Ne pritje të konfirmimit nga Eurostat për data points 2019

Zhvillimet në Sistemin Kombëtar Statistikor

Strategjia për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor

Përgatitja e dokumentit të Strategjisë për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor ka qenë një ndër prioritetet kresore të INSTAT-it për vitin 2019. Me mbështetjen e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe me bashkëpunimin e një grupi ekspertësh vendas e të huaj është mundësuar hartimi i projektdokumentit i cili është publikuar edhe në faqen zyrtare të INSTAT-it. Për hartimin e Projekt-Strategjisë janë zhvilluar një numër workshopesh, tryeza të rumbullakëta, takime bilaterale etj. me përfaqësues të grupeve të interesit si bota akademike, institucionet publike që japin të dhëna për prodhim statistikor, përdorues të statistikave zyrtare, media etj. Takimet e shumta dhe informacioni i mbledhur nga aktorët e përfshirë në sistem, ekspertët kanë hartuar një raport të hollësishëm mbi situatën e Sistemit Kombëtar Statistikor në vend, duke evidentuar mangësitë dhe propozuar veprime konkrete zhvillimore. Një ndihmë të konsiderueshme për hartimin e projektdokumentit ka qenë edhe Raporti *Peer Review* 2018 i hartuar me mbështetjen e Eurostat. Projekt-Strategjia shoqërohet edhe me një plan të posaçëm veprimi, në terma afat-mesëm, i cili do të bëhet gjithashtu pjesë e planeve të punës në periudhat në vazhdim.

Projekt-Strategjia për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor përfshin periudhën 2020-2030 është ndërmarrë në kontekstin e:

- a. mbështetjes së qeverisë shqiptare për zhvillimin statistikor;
- b. procesin drejt integrimit në Bashkimin Evropian;
- c. zbatimit të rekomandimeve të BE-së për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në Shqipëri sipas *acquis communautaire* për statistikat;
- d. rritjen e vazhdueshme të kërkesës për sasi më të mëdha dhe cilësi të dhënash nga përdoruesit në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar për qëllime politikash, planifikimi dhe monitorimi;
- e. ndryshimeve të shpejta në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për statistikat;
- f. Hyrjes në fuqi të ligjit të ri Nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, i cili sjell standarde të reja në përputhje me kërkesat evropiane.

Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare (PSZ) 2017-2021 është në zbatim dhe përmban objektivat strategjike për zhvillimin e statistikave zyrtare dhe SKS-së për një periudhë pesëvjeçare. Megjithatë, kërkohet një dokument më afatgjatë planifikimi strategjik, i cili do të jetë dokumenti bazë për hartimin e programit të ri pesëvjeçar. Për këtë arsye, projektdokumenti përfshin periudhën 2020-2030.

Në rezolutën e tij të vitit 2019, Kuvendi i Shqipërisë ka rekomanduar (Rekomandimi nr. 5) hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor me synim përmbushjen e rekomandimeve të Eurostatit për forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe zbatimin e parimeve statistikore evropiane. Sipas kësaj rezolute, Kuvendi sugjeron krijimin e një plani konkret veprimi për zbatimin e kësaj Strategjie.

Projektdokumenti është ndihmuar edhe nga gjashtë procese vlerësimi: Vlerësimi Global 2010, Procesi i Vlerësimit të Kufizuar të Sistemit Statistikor “Peer Review 2013” dhe “Peer Review rishikues 2015”, Analiza Sektoriale e statistikave të biznesit në 2015, Analiza Sektoriale e Anketës së Forcave të Punës në 2016, si dhe “Peer Review 2018”. Sugjerimet, udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna në këto vlerësime ishin instrumente të mira për të orientuar INSTAT-in në:

i) procesin e rishikimit të Ligjit për Statistikat, për ta bërë më mbështetës në proceset e zhvillimit statistikor, dhe

ii) prezantimin e një sërë përmirësimeve në statistika dhe procese statistikore.

Pas vitesh zhvillimi të vazhdueshëm, shumica e veprimeve të rekomanduara për përmirësim janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, p.sh., në lidhje me *Peer Review* të viteve 2015 dhe 2018, INSTAT ka përpiluar një plan të detajuar dhe gjithëpërfshirës për të zbatuar gjithë rekomandimet e lëna nga ekspertët e Eurostatit. Përveç miratimit të dokumentit bazë legjislativ, të tjera rezultate janë arritur në ndërtimin e Sistemit Kombëtar Statistikor. Në këtë mënyrë, SKS ka përmirësuar infrastrukturën dhe proceset e veta drejt të qenit në një linjë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Si rezultat, është bërë tashmë e domosdoshme dhe e mundur që Sistemi Kombëtar Statistikor të përcaktojë strategjitë e veta për të ecur dhe përfituar prej këtyre ndryshimeve drejt një rezultati të suksesshëm për përdoruesit e statistikave shqiptare. Projektdokumenti i ka të përcaktuara këto strategji në terma afatgjatë, shoqëruar edhe me planin e veprimit për zbatimin e tij në terma afatmesme. Së fundmi, projekt-strategjia është diskutuar në Këshillin e Statistikave, organ i cili ka lënë disa rekomandime për ta përshtatur strukturën e saj në përputhje me strategjitë e tjera të cilat monitorohen në Këshillin e Ministrave, si dhe për të evidentuar kostimin e aktiviteteve zbatuese në formën sa më të detajuar të mundshme, me qëllim që të orientohen dhe konkretizohen kërkesat për fonde.

Zbatimi i Planit Vjetor 2019 për PSZ

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë i cili përcakton objektivat strategjike të zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe aktivitetet prioritare statistikore për tu përmbushur nga sistemi gjatë harkut kohor prej pesë viteve. Programi hartohet nga INSTAT në bashkëpunim me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare dhe pasi diskutohet në Këshillin e Statistikave dhe grupet e interesit, i përcillet Kuvendit të Shqipërisë për miratim. Mbështetur në ligjin e ri për statistikën zyrtare, zbatimi i Programit sigurohet nëpërmjet një Plani Vjetor, dokumenti i cili miratohet gjithashtu nga Kuvendi. Programi aktual përfshin periudhën 2017-2021.

Për vitin 2019, në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 ishin parashikuar 117 aktivitete statistikore për tu realizuar, nga të cilat 2 mbulohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 9 nga Banka e Shqipërisë dhe 106 nga INSTAT. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë kanë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin, ndërsa INSTAT nuk ka realizuar 4 aktivitete statistikore si më poshtë:

1. Statistika të regjistrimeve në arsimin parauniversitar;
2. Ndërtimi i “Live Register” për përditësimin në kohë reale të regjistrit statistikor të ndërmarrjeve;
3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe agjencive të tyre në varësi, për prodhimin e statistikave të cilësisë së ajrit;
4. Inventarizimi i numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre.

Informacion më i detajuar rreth aktiviteteve të përfunduara ndodhet në fund të këtij seksioni.

Gjatë vitit 2019, INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë angazhuar për të realizuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Programit. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për të dhënat administrative janë realizuar aktivitetet statistikore sipas Planit Vjetor të PSZ-së 2019, ku në fushën e *Statistikave Sociale* dhe *Demografike* janë realizuar temat statistikore si: Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj; Puna dhe kostot e punës; Shëndetësia; Të ardhurat dhe konsumi; Mbrotjtja sociale; Drejtësia dhe krimi; Kultura. Ndërsa tema e statistikave të Arsimit dhe trajnimeve është realizuar pjesërisht, pasi nuk është realizuar aktiviteti për prodhimin e statistikave të Regjistrimeve në Arsimin parauniversitar.

Në fushën e *Statistikave Ekonomike* janë realizuar temat statistikore si: Statistikat Makroekonomike; Statistikat financiare të Qeverisë, fiskale dhe sektorit publik; Ndërsa pjesa i përket temës së Statistikave të Biznesit nga 9 aktivitete të planifikuara janë realizuar 8, pasi

nuk është realizuar aktiviteti statistikor për ndërtimin e Live Register për përditësimin në kohë reale të regjistrit statistikor të ndërmarrjeve.

Për prodhimin e *Statistikave Sektoriale* janë realizuar të gjitha aktivitetet e parashikuara në planin vjetor të PSZ-së 2019, sipas temave përkatëse, si: Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi; Energjia; Transporti; Turizmi; Tregtia e jashtme; Bilanci i Pagesave; Çmimet; Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni.

Përsa i përket fushës së *Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain* për temën e Statistikave të Mjedisit nga 7 aktivitete të planifikuara, 6 aktivitete janë realizuar plotësisht dhe pjesërisht aktiviteti për Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe agjencive të tyre në varësi për prodhimin e statistikave të ajrit dhe zhurmave, pasi nuk janë prodhuar statistikatat mbi Cilësinë e Ajrit, po ashtu për temën e Informacionit statistikor rajonal dhe gjeohapësinor është realizuar e plotë mund të themi që është bërë inventarizimi i ndërtesave në shkallën 99 % ndërsa 1 % e ndërtesave dhe banesave nuk u përditësua pasi u pezullua puna për shkak të tërmetit të 26 Nëntorit.

Informacioni në vijim paraqet në mënyrë të detajuar aktivitetet kryesore të realizuara sipas fushave përkatëse statistikore.

Produktet statistikore në fushën e Statistikave Sociale dhe Demografike

Fusha e statistikave sociale dhe demografike përfshin një gamë të gjerë treguesish në PSZ dhe kërkon angazhimin e një pjese të konsiderueshme të burimeve financiare dhe njerëzore. Në të përfshihen statistika demografike të popullsisë, forcave të punës, arsimit, shëndetësisë, konsumit në familje, mbrojtjes sociale etj. Gjatë vitit 2019, INSTAT ka prodhuar tregues të popullsisë sipas strukturës moshore, gjinisë dhe qarqeve, statistika mbi të huajt me leje qëndrimi dhe azil-kërkuesve; tregues gjinorë; statistika të punësimit dhe papunësisë, statistika të krimeve dhe arsimit, shëndetësisë, konsumit, mbrojtjes sociale etj.

Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj kategorie, janë kryer vërtetime statistikore, si: Anketa e Buxhetit të Familjes 2018, Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2018, Anketa Tremujore e Forcave të Punës Tregu i Punës si dhe Anketa e Strukturës së të ardhurave nga Puna.

Në vijim, aktivitetet kryesore statistikore të realizuara gjatë vitit 2019:

- Statistikat e Popullsisë
- Migracioni Ndërkombëtar
- Statistikat Vitale

- Statistikat e azilit dhe të huajve
- Statistikat gjinore
- Anketa Tremujore e Forcave të Punës
- Statistikat e Tregut të Punës
- Anketa e Strukturës së të ardhurave nga Puna
- Të dhëna administrative mbi pagat
- Statistika të regjistrimeve në arsimin pasuniversitar
- Statistika të diplomimeve në arsim
- Shpenzimet e buxhetit të shtetit mbi arsimin publik
- Shkaqet e vdekjeve
- Shëndeti publik
- Anketa e Buxhetit të Familjes
- Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës
- Të dhëna administrative mbi mbrojtjen sociale
- Statistikat ESSPROS
- Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale
- Statistika mbi veprat penale
- Tregues për të dhënat e Kulturës

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparshikuara ne PSZ:

- Anketa e Migracionit në Shqipëri
- Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (SILC +)
- Anketa e Dëmtimeve të familjeve nga Tërmeti
- Pilotimi i ABF 2019 në 6 bashki kryesore, me qëllim studimin mbi mundësinë e prodhimit të treguesve të konsumit në nivel Bashkie
- Fillimi i punës për anketën e Shëndetit EHIS
- Përgatitja e një press release vjetor në fushën e statistikave të krimeve “Statistikat e Krimeve dhe Drejtësisë Penale, 2019
- Fillimi i punës për ICCS, hartëzimi i veprave penale të Kodit Penal të Shqipërisë sipas kodeve në klasifikimin ndërkombëtar ICCS
- Publikimi për herë të parë në Vjetarin Rajonal të treguesve të arsimit sipas bashkive;
- Llogaritja për herë të parë e Indeksit të Barazisë Gjinore për Shqipërinë

Produktet statistikore në fushën e Statistikave Ekonomike

Në lidhje me statistikat e fushës ekonomike, Sistemi Kombëtar Statistikor gjatë vitit 2019 ka prodhuar treguesit e llogarive kombëtare në frekuencë vjetore dhe tre-mujore tregues strukturorë dhe afatshkurtër për ndërmarrjet; statistika monetare dhe financiare, të borxhit etj.

Për prodhimin cilësor të këtyre treguesve, janë kryer vrojtime statistikore, si: Vrojtimi vjetor për statistikatat strukturore të ndërmarrjeve ekonomike, Vrojtimi tremujor për statistikatat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike, Vrojtimi tremujor për statistikatat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike, Vrojtimi vjetor për statistikatat e produkteve industriale si dhe vrojtimi statistikor vjetor “Anketa e regjistrimit të ndërmarrjeve”.

Në vijim, aktivitetet kryesore statistikore të realizuara gjatë vitit 2019:

- Llogaritë Vjetore sipas sektorëve institucionalë
- Llogaritë kombëtare vjetore-Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Prodhimit
- Llogaritë kombëtare vjetore-Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) me metodën e Shpenzimeve
- Vlerësimi dhe publikimi i PBB tremujore me metodën e prodhimit me çmime korrente dhe konstante, vlerësime të papërshtatura dhe përshtatura sezonalisht
- Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve kryesor të PBB tremujore me metodën e shpenzimeve, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht
- Tabelat burime, përdorime dhe tabelat input-output
- Llogaritë rajonale
- Llogaritë financiare – Metodologjia
- Llogaritë financiare – Prodhimi i të dhënave
- Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese; Agregatët monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kreditë
- Statistikat e normave të interesit aplikuar për sasitë e reja dhe sasitë gjendje
- Bilanci sektorial dhe paraqitja monetare e korporatave të tjera financiare
- Statistikat Financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
- Statistikat e borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar
- Vrojtimi vjetor për statistikatat strukturore të ndërmarrjeve ekonomike
- Vlerësimi i statistikave strukturore në nivel rajonal për treguesit kryesorë
- Vrojtimi vjetor për listën e mallrave industriale pranë ndërmarrjeve ekonomike.
- Vrojtimi tremujor për statistikatat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike
- Vrojtimi tremujor për statistikatat e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike
- Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative dhe statistikore për përditësimin e regjistrave të njësive ekonomike
- Vrojtimi statistikor vjetor “Anketa e regjistrimit të ndërmarrjeve”, pranë ndërmarrjeve ekonomike

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparshikuara në PSZ:

- Metadatat e Llogarive Kombëtare
- Politika e harmonizuar e revizionimit të treguesve makroekonomik

Produktet statistikore në fushën e Statistikave Sektoriale

Rritja e cilësisë dhe shtimi i treguesve të kësaj fushe i mundëson politikëbërësve të hartojnë strategjitë e duhura për planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e aktiviteteve në sektorët e Bujqësisë, Energjisë, Transportit, Turizmit, Tregtisë së Jashtme, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj fushe statistikore, janë kryer edhe një sërë vërtetimesh të tjera ose pilot, si: Vërtetimi vjetor në bujqësi 2019, Vërtetim mbi sipërfaqen e mbjellë 2019, Vërtetimi muhor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta, Vërtetimi muhor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve, Vërtetimi muhor në pularitë për prodhimin e vezëve, Vërtetimi vjetor në të gjitha fabrikat dhe baxhot që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht, Vërtetimi muhor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës, Anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore si dhe Anketa tremujore e çmimeve të inputeve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështim. Për prodhimin e Statistikave të Turizmit është kryer Anketa e Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime" dhe anketa mujore e Turizmit në strukturat akomoduese. Në fushën e çmimeve janë realizuar vërtetimet për matjen e Fuqisë Blerëse dhe vërtetimet për çmimet e konsumit si dhe në fushën e Shkenës dhe Teknologjisë është realizuar Vërtetimi vjetor mbi Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në ndërmarrje, Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Njësitë Ekonomike Familjare (NjEF) dhe vërtetimi pranë ndërmarrjeve për aktivitetin e Inovacionit.

Në vijim, aktivitetet kryesore statistikore të realizuara gjatë vitit 2019:

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative
- Vërtetimi Vjetor në Bujqësi 2018
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për statistikën e produkteve bimore
- Vërtetimi mbi sipërfaqen e mbjellë 2019
- Vërtetimi vjetor në bujqësi 2019
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për statistikën e blegtorisë, mishit dhe vezëve
- Vërtetimi muhor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta
- Vërtetimi muhor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve
- Vërtetimi muhor në pularitë për prodhimin e vezëve
- Vërtetimi vjetor në të gjitha fabrikat dhe baxhot që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht
- Vërtetimi muhor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për statistikën e qumështit dhe nënprodukteve të tij
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative vjetore për llogaritë ekonomike në bujqësi
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative tremujore për llogaritë ekonomike në bujqësi
- Anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore
- Anketa tremujore e çmimeve të inputeve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështim
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për prodhimin e statistikave mbi prodhimin e peshkut
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për akuakulturën
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative tremujore për statistikën e peshkimit
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për Statistikën e prodhimeve organike në bujqësi
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për statistikën e agromjedisit
- Bilanci i energjisë elektrike
- Bilanci i përgjithshëm i energjisë
- Prodhimi i treguesve statistikorë mbi transportin ajror, detar, ujor i brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve
- Prodhimi i treguesve statistikorë mbi Aksidentet
- Prodhimi i treguesve statistikorë mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë
- Anketa mujore e turizmit në strukturat akomoduese
- Botimi "Turizmi në Shifra"
- Anketa e Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime"
- Botimi "Bizneset e Huaja në Shqipëri"
- Investimet direkte mjete dhe detyrime
- Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve
- Prodhimin e treguesve statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave.
- Prodhimi i treguesve statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.
- Bilanci tremujor i pagesave
- Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare
- Kryerja e vërtetimit dhe vlerësimit të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK)
- Vlerësimi i Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK)
- Matja e Fuqisë Blerëse (MFB)
- Statistikat mbi Çmimet e Banesave (SÇB)
- Vërtetimi vjetor i Inovacionit pranë ndërmarrjeve ekonomike
- Vërtetimi vjetor mbi "Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit" në ndërmarrje
- Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Njësitë Ekonomike Familjare (NjEF)

- Zhvillimi i udhërrëfyesve (guidelines) për sigurimin e konfidencialitetit statistikor si për të dhënat mikro edhe për ato tabulare
- Dokumentimi i proceseve ekzistuese të sigurimit të konfidencialitetit statistikor
- Implementimi dhe standardizimi i metadatave strukturore në INSTAT
- Implementimi dhe standardizimi i metadatave referenciale në INSTAT
- Trasferimi në Eurostat i metadatës në përputhje me standartin evropian për të gjitha fushat e prodhimit statistikor
- Publikimi në faqen e ëeb-it të INSTAT i raporteve të metadata-ve sipas fushave të prodhimit statistikor
- Rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi në lidhje me rëndësinë e metadatave për agjencitë e tjera statistikore
- Zhvillimi i udhërrëfyesve (guidelines) për tu përdorur nga INSTAT dhe agjencitë e tjera statistikore
- Dokumentimi i proceseve ekzistuese sipas modelit GSBPM
- Implementimi dhe standardizimi i metadatave strukturore dhe referenciale në INSTAT
- Trasferimi në Eurostat i metadatave në përputhje me standartin evropian
- Publikimi në faqen e ëeb-it të INSTAT i raporteve të metadata-ve sipas fushave të prodhimit statistikor
- Matja e kënaqësisë së përdoruesve dhe punonjësve
- Plotesimi i pyetësorëve të vetëvlerësimit për 4 aktivitete statistikore
- Auditi statistikor për 2 aktivitete statistikore

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparshikuara në PSZ:

- Publikim i treguesve mbi aktivitetin e Inovacionit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Produktet statistikore në fushën e Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain

- Statistikat e mjedisit dhe multidomain përfshijnë statistikën e mjedisit dhe statistikën rajonale dhe gjeohapësinore. Ndër treguesit kryesorë të kësaj fushe mund të përmendim statistikën mbi Llogaritë fizike dhe monetare në mjedis, statistikën e Ujit, statistikën e Mbetjeve dhe statistikën e Zhurmave, ku për prodhimin cilësor të treguesve mbi mbetjet është kryer dhe vrojtimi vjetor mbi mbetjet e ngurta urbane. Ndërsa për temën e Informacionit statistikor rajonal dhe gjeohapësinor mund të vecojmë aktivitetin e Inventarizimit të numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre, ku gjatë vitit 2019 pothuajse ka përfunduar procesi i mbledhjes së të dhënave për Inventarizimin e numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre, nëpërmjet përdorimit të tabletave në terren.

Në vijim, aktivitetet kryesore statistikore të realizuara gjatë vitit 2019:

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe agjencitë e tyre për prodhimin e statistikave mbi taksat mjedisore
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencitë e tyre për prodhimin e statistikave mbi llogaritë rrjedhëse fizike në mjedis
- Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në të dhënat administrative
- Prodhimi vjetor i statistikave mbi mbetjet, bazuar në vërtetimin mbi mbetjet e ngurta urbane
- Prodhimi vjetor i statistikave të ujit, bazuar në të dhënat administrative
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe agjencitë e tyre në varësi për prodhimin e statistikave të zhurmave
- Inventarizimi i numrit të ndërtesave dhe karakteristikave, përditësuar 99% e tyre.

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparshikuara në PSZ:

Nuk ka

AKTIVITETE TË PAREALIZUARA

Nga 117 aktivitete statistikore të parashikuara në Program, për vitin 2019, 4 aktivitete statistikore nuk janë realizuar. Informacioni mbi aktivitetet e porealizuara dhe shkaqet e mosrealizimit të tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4: Lista e aktiviteteve të porealizuara apo jo të përputhura plotësisht me standartet e Eurostatit, për vitin 2019

Nr	Aktivitete	Shkaku i mosrealizimit
1	Statistika të regjistrimeve në arsimin parauniversitar	Mosardhja e të dhënave nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në afatin e kërkuar, për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit, 2019.
2	Ndërtimi i "Live Register" për përditësimin në kohë reale të regjistrimit statistikor të ndërmarrjeve	Janë mbledhur të dhënat por nuk janë përpunuar sepse përpunimi kërkon suportin e IT për vënien në funksion të modelit të të dhënave
3	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe agjencitë e tyre në varësi për prodhimin e statistikave të cilësisë së ajrit	Nuk janë marrë të dhënat administrative pasi vetë Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka grumbulluar të dhëna për këtë aktivitet referuar vitit 2018.

4	Inventarizimi i numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre. (1% e ndërtesave dhe banesave është e papërditësuar për shkak të pezullimit të punës nga fenomeni i tërmetit të datës. 26 Nëntor, 2019. Zonat e afektuara nga tërmeti janë parashikuar të përditësohen gjatë 6-mujorit të parë 2020).
---	---

Shkaqet e mosrealizimit

1. Aktiviteti “Statistika të regjistrimeve në arsimin parauniversitar” nuk është realizuar pasi nuk janë marrë të dhënat nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në afatin e kërkuar, për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit, 2019.
2. Aktiviteti “Ndërtimi i “Live Register” për përditësimin në kohë reale të regjistrit statistikor të ndërmarrjeve” nuk është realizuar, pasi përpunimi i të dhënave kërkon suportin e IT për vënien në funksion të modelit të të dhënave.
3. Aktiviteti “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe agjencive të tyre në varësi për prodhimin e statistikave të cilësisë së ajrit” nuk është realizuar, sepse nuk janë marrë të dhënat administrative, pasi vetë Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka grumbulluar të dhëna për këtë aktivitet referuar vitit 2018.
4. Aktiviteti “Inventarizimi i numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre” nuk është realizuar 100%, pasi 1% e ndërtesave dhe banesave është e papërditësuar për shkak të pezullimit të punës nga fenomeni i tërmetit të datës 26 Nëntor, 2019. Zonat e afektuara nga tërmeti janë parashikuar të përditësohen gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2020.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

INSTAT në kuadër të zbatimit të Agjendës 2030, për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm ka përgatitur botimin e dytë me indikatorë statistikorë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, punë që ka filluar që prej vitit 2019 me botimin e parë të treguesve statistikorë si dhe me platformën për OZHQ-të, mbështetur nga UNDP, e cila përditësohet vazhdimisht dhe gjendet në faqen zyrtare të INSTAT <http://instat.gov.al/al/sdgs/>

Botimi këtë herë vjen më i pasuruar me indikatorë të rinj, ndërkohë INSTAT ka në planet e tij afatshkurtra dhe afatmesme, vijimin e punës për prodhimin e indikatorëve të rinj si dhe futjen e disa pyetjeve të reja në anketat ekzistuese të cilat do të shërbejnë për prodhimin e indikatorëve të rinj në linjë me metodologjinë e Kombeve të Bashkuara.

INSTAT, si institucioni lider në prodhimin e statistikave zyrtare në vend, ka kontribuar vazhdimisht në validimin e indikatorëve të OZHQ-ve, prodhuar nga agjensitë përgjegjëse për indikatorët specifikë të Kombeve të Bashkuara.

INSTAT gjithashtu do të vijojë punën për mbështetjen në përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim III, ku synohet harmonizimi i saj me treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, OZHQ. Për këtë arsye, INSTAT është pjesë e grupeve teknike të punës ndërinstitutionalë për përcaktimin e objektivave paraprakë, për periudhën afatmesme 2023 – 2024 të cilët do të ndihmojnë fazën e mëtejshme të ndërtimit të vizionit 2030 dhe atij të SKZHI III.

Nisma të reja për vitin 2020

Me qëllim përgjigjen sa më të mirë të kërkesave të përdoruesve si dhe rritjen e cilësisë së produkteve statistikore, duke marrë parasysh edhe gjendjen e vendit tonë në kuadër të hapjes së negociatave, për vitin 2020 INSTAT ka ndërmarrë iniciativa të reja në të gjitha fushat e prodhimit statistikor dhe modernizimin e infrastrukturës së prodhimit. Kështu, në fushën e *Statistikave Sociale dhe Demografike* do të realizohen aktivitetet si: aktivitetet përgatitore të Censit të Popullsisë dhe Banesave, revizionimi i të dhënave të ABF 2018, publikimi i rezultateve të SILC + për 15 bashkitë, publikimi i raportit të rezultateve të Anketës së Dëmtimeve nga Tërmeti, kryerja e Anketës EHIS, publikimi i rezultateve të Anketës së Strukturës së të Ardhurave, përgatitja e për kryerjen e Anketës së Kostos së Punës, etj. Në fushën e *Statistikave Ekonomike* ndër të tjera mund të veçohet Revizionimi madhor i treguesve të Llogarive Kombëtare si dhe Revizionimin e serisë tremujore për treguesit e PBB-së. Përsa i përket fushës së *Statistikave Sektoriale* do të publikohen statistikat për prodhimet organike, do të testohet metoda *Computer-assisted personal interviewing (CAPI)* për vrojtimet mujore në bujqësi si dhe si pjesë e llogarive ekonomike në bujqësi do të llogaritet indeksi i çmimeve të Input 2, i cili ka për qëllim indeksat e çmimeve të makinerive bujqësore si dhe do të kryhet trasmetimi i tyre në Eurostat. Gjithashtu do të publikohen të dhënat për Inovacionin, statistikat e turizmit të strukturave akomoduese si dhe treguesit për karakteristikat e mjeteve të transportit. Në fushën e *Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain*, me qëllim shtimin e treguesve statistikor, do të vlerësohen burimet e të dhënave për llogaritjen e moduleve të llogarive monetare mjedisore si dhe llogarive fizike mjedisore. Gjithashtu, gjatë vitit 2020, bazuar në të dhënat administrative, do të mbledhen të dhëna vjetore mbi llogaritë e emetimeve në ajër dhe në ujë. Në mbështetje të Cens do të behët Përditësimi i Gjeodatabazës, dhe fillojë puna përgatitore e hartave të ZC-ve.

Më poshtë paraqiten në mënyrë të detajuar aktivitetet e reja statistikore të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit 2020 sipas fushave kryesore statistikore:

Statistikat demografike dhe sociale

- Përgatitja e Censit të Popullsisë e Banesave
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Migracionit
- Publikimi i treguesve të modulit të Fëmijëve
- Kryerja e anketës së shëndetit EHIS
- Revizionimi i të dhënave të ABF 2018 për shkak të ndryshimit metodologjik

- Publikimi i rezultateve të SILC + për 15 bashkitë
- Publikimi i raportit të rezultateve të Anketës së Dëmtimeve nga Tërmeti
- Finalizimi i përpunimit të të dhënave nga Anketa e Strukturës së të Ardhurave si dhe publikimi i tyre.
- Përgatitja, gjatë tremujorit të dytë 2020, i kryerjes së Anketës së Kostos së Punës në vitin 2021.

Statistikat ekonomike

- Revizionimi madhor i treguesve të Llogarive Kombëtare
- Publikimi dhe Transmetimi i serisë së revizionuar
- Revizionimin e serisë tremujore për treguesit e PBB-së

Statistikat sektoriale

- Publikimi i statistikave mbi prodhimet organike
- Dërgimi për herë të parë në Eurostat nëpërmjet platformës eDamis i të dhënave lidhur me statistikën e Peshkimit, Akuakultures si dhe flotës Detare
- Llogaritja e indeksit të çmimeve të Input 2, i cili ka për qëllim indeksin e çmimeve të makinerive bujqësore si dhe do të kryhet transmetimi i tyre në Eurostat
- Publikimi për statistikën e turizmit të strukturave akomoduese
- Publikimi i treguesve të karakteristikave të mjeteve të transportit
- Revizionime madhore (Benchmark revision), në të njëjtën linjë me llogaritë kombëtare vjetore
- Ribazimi i indekseve të mëparshme, konkretisht rillogaritja e tyre me bazën e re (2020=100)
- Publikimi i treguesve të inovacionit
- Pilotimi i Sistemit të Informacionit për aksesin në mikrodata nëpërmjet internetit
- Harmonizimi i proceseve të statistikore në drejtim të GSBPM

Statistikat e mjedisit dhe multidomain

- Vlerësimi i burimeve të të dhënave për llogaritjen e moduleve të llogarive monetare mjedisore si dhe llogarive fizike mjedisore
- Mbledhja e të dhënave vjetore mbi llogaritë e emetimeve në ajër dhe në ujë, bazuar në të dhënat administrative.
- Përditësimi i Gjeodatabazës, fillimi i punës për përgatitjen e hartave të ZC-ve në mbështetje të Cens

Aktivitete të tjera jo-statistikore

Përveç aktiviteteve statistikore, për vitin 2020 janë parashikuar edhe aktivitete të tjera mbështetëse të cilat ndikojnë në mënyrë të tërthortë në cilësinë e statistikave zyrtare dhe besueshmërinë e publikut në to, ku ndër të tjera mund të veçojmë aktivitetet si më poshtë:

- Kostimi i Anketës së Buxhetit të Familjes
- Pilotimi dhe përdorimi i teknikave elektronike të mbledhjes së të dhënave për aktivitetet statistikore që nuk i kanë përdorur këto teknika
- Pilotimi i mënyrës standarde për prodhimin e statistikave (Moduli i Imputimit tek Statistical datawarehouse SITI)
- Përgatitja e udhëzimeve të Cilësisë

Censet

Censi i Popullsisë dhe Banesave

Censi i Popullsisë dhe Banesave është aktiviteti kryesor dhe më kompleks statistikor që zhvillohet në nivel vendi me një frekuencë 10 vjeçare. Ky ushtrim mundëson furnizimin e përdoruesve me të dhënat më të fundit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me natyrën demografike, sociale dhe gjeohapësinore të popullsisë dhe ndërtesave në vend.

Në kuadër të përgatitjeve për Censin e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave, gjatë vitit 2019 INSTAT ka ndërmarrë një sërë aktivitete:

- I. Fillimi i implementimit të kontratës “Mbështetje për zbatimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri”, kontratë e nënshkruar në datë 26 Qershor 2019 me një kohëzgjatje prej 4 vitesh dhe ka për qëllim ti sigurojë INSTAT ekspertizë dhe ngritje kapacitetesh për realizimin e aktiviteteve të Censit duke ofruar ekspertizë mbi menaxhimin dhe metodologjinë për realizimin e Censit, infrastrukturën TI që do përdoret, mbështetje për zhvillimin e strategjisë për komunikimin e Censit, për aktivitetet Gjeohapësinore, si dhe për tabulimin, analizën dhe shpërndarjen e rezultateve të Censit.
- II. Procesi i përditësimit të hartave në terren, i cili ka filluar në Prill 2019 dhe ka vazhduar deri në Dhjetor 2019. Procesi kishte për qëllim përditësimin e Zonave të Censit për të gjithë Shqipërinë nëpërmjet përdorimit të tabletëve me një aplikacion mobile të dedikuar, në mbështetje të Censit të Popullsisë dhe Banesave.
- III. Gjithashtu, gjatë periudhës 21 Tetor - 30 Nëntor 2019 u krye piloti për Censin e Popullsisë dhe Banesave në terren, i cili testoi në kushte reale të gjitha fazat e Censit. Pas përfundimit të pilotit, njësia e Cens në bashkëpunim me Asistencën Teknike, filluan punën për përgatitjen e raportit mbi gjetjet e Pilot Cens. Gjatë vitit 2019, janë kryer procedura tenderime për sigurimin e pajisjeve IT (hardware dhe software) të cilat kanë ndihmuar si në realizimin e aktiviteteve të fazës përgatitore si dhe do të jenë në funksion të fazës së numërimit.
- IV. Vlejnë për tu përmendur edhe përpjekjet e bëra nga INSTAT për përgatitjen e kuadrit rregullator për zbatimin e censit. Sipas ligjit për statistikat zyrtare, çdo cens zhvillohet sipas një kuadri ligjor të vecantë. Për këtë arsye, si dhe duke patur parasysh që:

- a) INSTAT ka një pozicionim të ri në institucionet e administratës publike, si i pavarur;
- b) Shqipëria ka një ndarje të re administrative krahasimisht me atë të vitit 2011;
- c) Kombet e Bashkuara dhe Eurostat kanë lëshuar një sërë rekomandimesh për kryerjen e censeve të radhës,

në vitin 2018 INSTAT ka paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë projekt-ligjin e ri “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Aktualisht projektligji është në proces shqyrtimi në komisionet parlamentare, ndërkohë që Komisioni i përhershëm për Integrimin Evropian dhe ai për Ekonominë e Financat kanë përgatitur mendimet dhe propozimet për projektaktin.

Aktivitetet e planifikuara në 2020

Viti 2020 rezervon një pjesë të madhe të aktiviteteve përgatitore të Censit. Në aspektin e përcaktimit të kuadrit ligjor për kryerjen e censit, brenda këtij viti INSTAT pret miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të projektligjit të ri “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Projektakti do të mundësojë përafrimin e standardeve të reja të Kombeve të Bashkuara për censet e radhës si dhe do të shërbejë si akti bazë për nxjerrjen e akteve të tjera të karakterit operacional, duke patur parasysh ndarjen e re administrative të Republikës së Shqipërisë, statusin e INSTAT si organi përgjegjës për mbarrëvajtjen e censit dhe rolin e organeve të vetëqeverisjes vendore.

Gjatë vitit 2020, do të përgatitet kryerja e një tjetër testi të Cens, qëllimi i të cilit është që të testohen elemente të ndryshëm bazuar në gjetjet e pilotit të kryer gjatë vitit 2019.. Aktivitetet do të vazhdojnë me përditësimin e zonave specifike në terren të censit (ZC), kryesisht zona të prekuara nga fatkeqësia natyrore (Tërmeti i 26 Nëntorit të 2019) dhe objekte në ndërtim gjatë 2019. Gjithashtu, aktivitetet e hartave të cens në fazën e para-numërimit do të vazhdojnë me: kontrollet e cilësisë të të dhënave të ardhura nga terreni dhe përditësimin e gjeodatabazës, përditësimi i kufijve të Zonave të Censit, gjeokodifikimi i njësive gjeografike, përgatitjen e hartave dixhitale të Zonave të Cens, për të gjithë zinxhirin e stafit të terrenit - anketues, kontrollor dhe mbikqyrës, krijimin e hartave “smart” (geodatabase/map format) sipas kërkesave të Njesisë së TI për tu testuar/aksesuar/integruar në aplikacionin e pyetësorëve të censit.

Gjatë këtij viti, do të vazhdojë puna për përmirësimin e pyetësorit të Censit si edhe materialeve të tjera shoqëruese, bazuar në gjetjet e Pilot Cens të kryer në 2019 si dhe në situatat e emergjencave të fundit që kanë ndodhur (tërmeti i Nëntorit të 2019 dhe Covid-19).

Nga ana tjetër, punë përgatitore do të kryhet edhe nga burimet njerëzore për realizimin e veprimtarive menaxhuese në bashkëpunim me njësitë e tjera dhe stafin e INSTAT-it.

Logjistika veç angazhimit që do të ketë për të realizuar me sukses dhe në kohë testin, do të synojë që të vërë në zbatim dhe monitorojë sa më shumë të jetë e mundur të gjitha procedurat që parashikohen të zhvillohen në Cens (përgatitje materialesh, organizim trajnimesh, shpërndarje dhe grumbullim materialesh, etj). Një element i rëndësishëm tek i cili do të punohet gjatë vitit 2020 do të jetë edhe vlerësimi i situatës në terren. Kjo parashikon që të zhvillohen takime me pushtetin vendor për të identifikuar sa më saktë mundësitë dhe elementët që do të mund të suportohen nga këto struktura, por njëkohësisht edhe mbledhur informacion dhe vlerësuar nevojat për rastet kur njësitë vendore nuk mund ta suportojnë Censin sipas kërkesave të tij.

Gjatë vitit 2020 bazuar edhe në gjetjet e Pilotit do të vazhdohet puna në lidhje me zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të Cens. Do të zhvillohen dhe testohen sistemet e TI për pyetësin elektronik si edhe sistemin e monitorimit të procesit të mbledhjeve të të dhënave në terren.

Censusi i Bujqësisë

Censi i rradhës i Bujqësisë, duke ndjekur rekomandimet e Programit Botëror për Censin e Bujqësisë 2020, është planifikuar të kryhet në vendin tonë në vitin 2022. INSTAT, gjatë vitit 2019, ka përgatitur një modul pyetjesh të cilat janë përfshirë në pyetësin e Censit të ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave, me qëllim përditësimin e listës së fermave bujqësore. Lista e përditësuar e fermave do të jetë korniza për Censin e ardhshëm të njësive ekonomike bujqësore.

Në punët përgatitore që ka zhvilluar INSTAT gjatë vitit 2019 përfshihet edhe përpjekja për gjetjet e burimeve të mundshme financiare. Për këtë, pranë Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme, delegacionit të BE-së në Tiranë si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë paraqitur zyrtarisht shkresa informative dhe kërkesa për mbështetje financiare të aktiviteteve. Gjithashtu, në takimin e organizuar me Donatorët, më 31 Tetor 2019, INSTAT prezantoi kërkesën për mbështetje për "Hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cens-in e Bujqësisë 2022". Hartimi i strategjisë përkatëse dhe eficientë do të shërbejë për të planifikuar dhe detajuar elementët më të rëndësishëm të projektit, do të shërbejë për përgatitjen e kuadrit rregullator dhe vlerësimin e burimeve dhe aktorëve që do të përfshihen më tej. Strategjia dhe Plani i Veprimit të Cens-it të Bujqësisë parashikohet të jetë gati brenda vitit 2020.

Bazuar në përcaktimin e qartë të vizionit dhe objektivave strategjike për kryerjen e censit, si dhe planin përkatës të veprimeve sa më të detajuara, do të jetë e mundur edhe tërheqja e fondeve nga donatorët të cilët kanë mbështetur vazhdimisht veprimtarinë statistikore në vend.

Cilësia e të dhënave

Cilësia e të dhënave statistikore konsiderohet tërësia e karakteristikave dhe elementëve të një produkti statistikor, i cili përmbush sa më shumë të jetë e mundur pritshmëritë e përdoruesve të tij. Kriteret themelore sipas të cilave statistikatat zyrtare duhet të prodhohen, janë të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare”, janë: “Rëndësia”, “Saktësia”, “Koha dhe Përpikëria”, “E drejta e hyrjes dhe Qartësia”, “Krahasueshmëria dhe Koherenca”, “Përkatësia”, “Transparenca”.

INSTAT gjatë vitit 2019 ka punuar në kuadër të sigurimit të cilësisë statistikore. Puna është fokusuar në hartimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave. Në përputhje me parimin 4, Cilësia statistikore, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT ka ndërmarrë disa iniciativa si: publikimi i Deklaratës së Cilësisë të INSTAT, dokumentimi i proceseve statistikore sipas modelit të përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore të njohur ndryshe edhe si GSBPM si edhe pilotimi për implementimin e Auditit Statistikor. Në përputhje me parimin 9, ngarkesa ndaj të intervistuarve, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT monitoron përmes dy treguesve bazë: numri i pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen si dhe kohëzgjatjen e intervistës.

Në vitin 2020, do të vazhdojë procesi i dokumentimit të produkteve statistikore, prodhimit të raporteve të cilësisë si dhe pilotimin e auditit statistikor. Deri në fund të vitit 2020 do të jenë të dokumentuara të gjitha aktivitetet statistikore që do të realizohen gjatë vitit sipas modelit GSBPM si edhe do të prodhohen 30 raporte cilësie sipas modelit të përcaktuar nga Sistemi Statistikor Evropian (ESS).

Dokumentimi i proceseve statistikore

INSTAT për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara për t'u kryer gjatë vitit 2019 zbatoi modelin e përgjithshëm të menaxhimit të proceseve statistikore të njohur ndryshe edhe si GSBPM (Generic Statistics Business Process Model), të implementuar në shumë shtete të Evropës dhe më tej. Në vetvete ky model përshkruan dhe përcakton të gjithë bashkësinë e proceseve të nevojshme për t'u ndjekur për prodhimin e statistikave zyrtare, duke siguruar një kornizë standarde dhe terminologji të harmonizuar. Në vitin 2019, INSTAT dokumentoi 60 aktivitete statistikore të cilat ndjekin këtë model. Gjithashtu për sistemin kombëtar statistikor u organizua një workshop me temën Metadatat dhe përdorimi i GSBPM.

Auditi Statistikor

Mbështetur në pikën 3 të nenit 17 të ligjit për statistikat zyrtare, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it mund të kryejë auditime statistikore tek prodhuesit e statistikave zyrtare, kur e gjykon të arsyeshme. Auditi statistikor është rruga konkrete për përmirësimin e cilësisë së një procesi apo produkti statistikor, nëpërmjet të cilit identifikohen pikat e forta dhe përmirësohen pikat e dobëta të komponentëve të tij. Auditimi është një proces sistematik, i programuar, i pavarur, i dokumentuar, me anë të të cilit bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. Me synimin për të rritur përmirësimin e cilësisë së proceseve statistikore, në vitin 2019 INSTAT nisi punën për kryerjen e auditit të proceseve statistikore. Hapat e implementuara ishin ndjekja dhe plotësimi i pyetësorëve për vetëvlerësimin e 4 aktiviteteve statistikore si edhe hartimi i draft raporteve për auditin statistikor për 2 aktivitete statistikore.

Raportet e Cilësisë

INSTAT ka publikuar për përdoruesit Raportet e Cilësisë në nivelin e produkteve statistikore, ku në vitin 2019 janë publikuar 30 raporte në faqen e web-it me një rritje prej rreth 42.9% krahasuar me vitin 2018. Raportet e cilësisë përshkruajnë konceptet dhe metodologjitë statistikore të përdorura për mbledhjen dhe gjenerimin e statistikave zyrtare. Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion mbi format e standardet që përdor INSTAT në metodat dhe përkufizimet e aplikuara si dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Struktura e Raporteve të Cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e produkteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Ngarkesa e të Intervistuarve

Ngarkesa e të intervistuarve është koha dhe përpjekjet e të anketuarve për tju përgjigjur pyetësoreve të INSTAT në mënyrë të kënaqshme për një aktivitet statistikor. Statistikat pranë ndërmarrjeve dhe familjeve përdorin dy tregues për të vlerësuar ngarkesën e të intervistuarve (Response burden): numrin e pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen si dhe kohëzgjatjen e intervistës.

Përgjatë vitit 2019 janë anketuar në 16 vrojtimet pranë ndërmarrjeve rreth 20.370 Ndërmarrje dhe në 14 vrojtime pranë familjeve rreth 81.870 Njësi Ekonomike Familjare.

Të gjitha anketat pranë ndërmarrjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2019 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Shpërndarja e numrit të

pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2019, duke marrë në konsideratë gjithë vërtetimet pranë ndërmarrjeve ekonomike, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1_9 të punësuar	141,086	12,170	229	704
10_19 të punësuar	501	2,790	491	249
20_49 të punësuar	510	1,083	912	265
50+ të punësuar	490	261	524	692

Në vitin 2019, janë anketuar rreth 12.5 % e ndërmarrjeve nga 162,627 ndërmarrje të regjistruara në vitin 2018. Janë intervistuar të paktën një herë gjatë vitit 20,370 ndërmarrje, nga të cilat 80.0 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në pesë ose më pak vërtetime, ndërsa 20.0 % e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se 5 vërtetime të realizuar nga INSTAT, pranë ndërmarrjeve gjatë vitit 2019.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2019-2015, duke marrë në konsideratë gjithë vërtetimet pranë ndërmarrjeve ekonomike, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.


Tabela 6: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve

Numri i ndërmarrjeve	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015
Intervistuar të paktën një herë	20,370	21,752	24,025	20,615	19,007
0 pyetësorë	142,257	140,700	136,748	131,613	93,465
Gjithsej	162,627	162,452	160,773	152,228	111,472

Në lidhje me “Ngarkesën e të intervistuarve”, për indikatorin “Numrin e pyetësorëve që INSTAT i dërgon ndërmarrjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet me vitet e mëparshme, pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2019, INSTAT ka realizuar 16 vërtetime pranë ndërmarrjeve ndër të cilët 4 prej tyre janë vërtetime të reja me frekuencë vjetore.

Tabela 7: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ Pyetësorë
50+ pun	24.9%	13.3%	26.6%	35.2%
20_49 pun	18.4%	39.1%	32.9%	9.6%
10_19 pun	12.4%	69.2%	12.2%	6.2%
1_9 pun	91.5%	7.9%	0.1%	0.5%

Figura 1: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar), ku është i përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre rreth 91,5 %, nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 7,9 % kanë për të plotësuar 1 deri në 5 pyetësorë dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre (më pak se 1 %) ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga grafiku, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar, 72.0 % e tyre ngarkohen deri në maksimumi 10 pyetësorë për t'u përgjigjur dhe vetëm 9,6 % e tyre ngarkohen me mbi 10 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart ku rreth 75,1 % e tyre duhet t'u përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

Anketat pranë familjeve

Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2019 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2019 janë anketuar rreth 11,3% Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Census. Janë intervistuar gjithsej 81.870 NJEF, nga të cilat 79.4% (64,970) e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim, ndërsa 20,6 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vrojtime të realizuar nga INSTAT, pranë familjeve gjatë vitit 2019. Shpërndarja e numrit të vrojtimeve

sipas qarqeve për vitin 2019, duke marrë në konsideratë të gjitha vërtetimet pranë familjeve që realizon INSTAT, jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8: Shpërndarja e numrit të vërtetimeve sipas qarqeve

Qarku	Asnjë vërtetim	Një vërtetim	Dy e më shumë vërtetime	Numri i NjEF për Qark
Berat	33,891	3,750	852	38,493
Dibër	25,799	3,035	739	29,573
Durrës	58,702	5,995	1,953	66,650
Elbasan	64,864	6,543	1,637	73,044
Fier	72,727	7,584	1,763	82,074
Gjirokastrë	18,431	2,264	592	21,287
Korçë	53,328	5,461	1,382	60,171
Kukës	14,648	1,952	526	17,126
Lezhë	28,300	3,011	925	32,236
Shkodër	48,147	5,024	1,258	54,429
Tiranë	175,996	16,115	4,107	196,218
Vlorë	45,559	4,236	1,166	50,961
Gjithsej	640,392	64,970	16,900	722,262

Gjatë vitit 2019, në qarkun e Tiranës janë intervistuar gjithsej 20,222 NJEF ose 10.3 % e tyre. Rreth 89.7 % e familjeve të qarkut Tiranë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë vërtetim, 8.2 % e tyre kanë marrë pjesë në 1 vërtetim dhe vetëm 2.1 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vërtetime të realizuara nga INSTAT.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2019-2015, duke marrë në konsideratë gjithë vërtetimet pranë njësive ekonomike familjare, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.


Tabela 9: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve

Numri i NjEF	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Viti 2016	Viti 2015
Intervistuar të paktën një herë	81,870	59,702	46,940	40,804	20,104
0 pyetësorë	640,392	662,560	675,322	681,458	702,158
Gjithsej	722,262	722,262	722,262	722,262	722,262

Indikatori “Numri i pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet me vitet e mëparshme pasi ndryshon numri i aktivitetve dhe frekuenca e tyre. Gjatë

vitit 2019, INSTAT ka realizuar 14 vrojtime pranë familjeve ndër të cilat 6 janë vrojtime të reja me frekuencë vjetore.


Figura 2: Ngarkesa e përgjigjes për NjEF që janë përzgjedhur për t'u intervistuar gjatë vitit 2019



Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve, që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrative. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e ngarkesës janë fokusuar në lehtësitë që mund t'i krijohen familjeve, përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit, që mund të jetë i disponueshëm.

Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta

Në lidhje me indikatorin e dytë kohëzgjatjen mesatare të intervistës për anketat pranë familjeve dhe ndërmarrjeve për vitin 2019, të dhënat jepen në figurën e mëposhtme.


Figura 3: Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta/ Pyetësorë

Kohëzgjatja e intervistës është më shumë për anketat pranë familjeve mesatarisht rreth 29.61 minuta krahasuar me 40.47 minuta në vitin 2018. Ndërsa për ato pranë ndërmarrjeve është 37.68 minuta krahasuar me 37.87 minuta në vitin 2018.

INSTAT për të reduktuar ngarkesën e të intervistuarave punon vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e pyetësorëve, programeve të mbledhjes së të dhënave, manualeve dhe trajnimin e anketuesëve.

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të INSTAT

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të INSTAT është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat e përdoruesve dhe adresuar reagimet e tyre aty ku është e mundur me procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Në Prill të vitit 2019 INSTAT zhvilloi raundin e tretë të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve të INSTAT në vitin 2019 është rritur me 1,1 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Një rritje e rëndësishme kundrejt vitit 2018 dallohet në indikatorin e kënaqësisë së cilësisë së të dhënave dhe shërbimeve që INSTAT ofron me 2,4 pikë përqindje. Gjatë vitit 2019 kanë pësuar gjithashtu rritje kënaqësia me faqen e internetit të INSTAT me 0,8 pikë përqindje dhe indikatorin e besimit se INSTAT ka të dhëna të besueshme me 3,9 pikë përqindje. Grafiku i mëposhtëm përshkruan krahasimin e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve.

Figura 4: Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë sipas viteve 2017-2019

Komunikimi dhe Publikimet

Gjatë vitit 2019, INSTAT ka kryer një sërë aktiviteteve për t'iu përafuar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigoroze parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare.


Duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në rendësinë e statistikave zyrtare INSTAT ka ndërtuar një strategji të vecantë drejtuar të gjithë grupeve të përdoruesve. Për më tepër, në vitin 2020 INSTAT ka planifikuar të lançojë projektin "Edukimi statistikor", i cili parashikon prezantimin e moduleve hyrëse në statistika për studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme. Gjatë vitit 2019, vizibiliteti i INSTAT është rritur në publik.

Disa tregues të rritjes së vizibilitetit të INSTAT dhe rritjes së performancës së sektorit të Publikimeve dhe Shpërndarjes së Informacionit gjatë vitit 2019:

- **PUBLIKIMET:** Gjatë vitit 2019, numri i publikimeve të INSTAT shkoi në 160 nga të cilët 9 ishin publikime të reja, krahasuar me vitin 2018 që ishin 159 publikime.
- **KËRKESAT E PËRDORUESVE:** Sa i takon kërkesave të përdoruesve, duke iu referuar databazës së kërkesave të përdoruesve, e cila është krijuar për herë të parë në vitin 2009, ku numri i kërkesave të përdoruesve për të dhëna statistikore ka ardhur në rritje. Në vitin 2019, numri i kërkesave të përdoruesve është 918 kërkesa, nga 1009 kërkesa që ka patur në vitin 2018 (91 kërkesa më pak).
- **RRJETI SOCIAL FACEBOOK:** Gjatë vitit 2019, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 5.705 pëlqime nga 5.252 pëlqime në 2018. Ku numri më i madh u arrit gjatë muaji Dhjetor 2019.
- **VIZIBILITETI NË MEDIA:** Përmendja dhe citimi i INSTAT gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 është vërejtur gjithsej 2,870 herë (gjatë vitit 2018 numri i përmendjeve ishte 3.686 herë) në përmbajtjen e 1,644 artikujve të botuar në shtypin shqiptar, ndërkohë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme rezultojnë 53 përmendje. Në edicionet kryesore të lajmeve të 9 TV-ve kryesore shqiptare përmendja dhe citimi i INSTAT, është vërejtur gjithsej 494 herë në përmbajtjen e 315 kronikave të transmetuara në 9 TV kryesore. Përmendja dhe citimi në portalet online është vërejtur 7,516 herë në përmbajtjen e 6,611 artikujve.
- **STATISTIKAT E WEBSITE:** Për vitin 2019 faqja web e INSTAT ka pasur 2.001.281 page view[1] nga 1.341.928 në vitin 2018 me një rritje prej 659.353 shikimesh, 49,13%.

[1] Pageviews – Shikimi i faqeve është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikime

Figura 5: Gjatë vitit 2019, janë publikuar 160 publikime, nga të cilat 9 të reja



Publikimet e reja

- Projektionet e Popullsisë
- Statistikat e Pagave
- Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
- Statistikat e Pylltarisë dhe Biodiversitetit
- Statistikat Peshkimit
- Turizmi në Familje
- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit në Familje
- Regjistrimet në Arsimin Parauniversitar
- Sustainable Development Goals - SDG

Librat

- Tregtia e Jashtme e Mallrave dhe Ndërmarrjet, 2018
- Burra dhe Gra në Shqipëri, 2019
- Tregu i Punës, 2018
- Regjistri i Ndërmarrjeve, 2018
- Turizmi në Shifra, 2019
- Shqipëria në Shifra, 2018
- Vjetari Statistikor Rajonal, 2019
- Diaspora e Shqipërisë në Shifra, 2019
- Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, 2018
- Sustainable Development Goals - SDG

Vjetari Statistikor Rajonal 2019

VJETARI
STATISTIKOR RAJONAL



INSTAT


Vjetari Statistikor Rajonal është një instrument orientues për përdoruesin, duke ofruar një përmbledhje të plotë të statistikave rajonale në një vëllim të vetëm për vitin 2019. Ky botim i përbërë prej 160 faqesh, i ndarë në 18 kapituj, ku për çdo qark ka një profil me treguesit më përfaqësues të qarkut, ndjekur nga 17 kapituj tematikë. Risia e këtij botimi është pasurimi me tregues të rinj në nivel bashkie, profile më të pasura të qarqeve, si dhe prodhimi i indikatorëve në vend të shifrave absolute për të patur një qasje më analitike ndaj diferencave që kanë qarqet apo bashkitë me njëra tjetrën. Ky botim do të vijë duke u përmirësuar

nga viti në vit me tregues dhe të dhëna të reja. më të vogla, të cilësuar si njësi administrative. Në përbërje të tyre janë edhe qytetet dhe fshatrat.

Diaspora e Shqipërisë në Shifra

Ky publikim kryhet për herë të parë nga INSTAT në kuadër të Strategjisë së Diasporës. Qëllimi i tij është vlerësimi i numrit të diasporës shqiptare dhe profilin e saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale. INSTAT do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet partnere të vendeve pritëse të diasporës shqiptare në vijim për të arritur në statistika edhe më gjithëpërfshirëse. Migrimi i shqiptarëve jashtë vendit nuk është një dukuri e re. Ajo është e dokumentuar të paktën që në shekujt e pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë me largimin e një mase të madhe banorësh të trevave shqiptare. Ai

vazhdon ende të mbetet veprues dhe të japë impaktet e tij domethënëse si në aspektet demografike po ashtu edhe ato sociale dhe ekonomike të vendit.



Turizmi në Shifra 2019



Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi një publikim të veçantë për treguesit kryesorë mbi turizmin në Shqipëri. Duke iu referuar periudhës 2014-2018, statistikatat në lidhje me turistët e huaj dhe vendas në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e turizmit në vendin tonë. Në strategjinë e re të komunikimit, INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve, duke targetuar grupe të ndryshme përdoruesish, duke bërë një publikim më të kuptueshëm nga përdoruesit. Materiali pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi turistët të huaj dhe vendas dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare. Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të grupeve të interes në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është kontribut, jo vetëm i INSTAT, por dhe i furnizuesëve të të dhënave, duke veçuar ministritë e linjës dhe Bankën Qendrore.

Regjistri i ndërmarrjeve

Publikimi “Regjistri i ndërmarrjeve, 2018” përmban të dhëna të detajuara për njësitë ekonomike që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Treguesit në këtë botim bazohen në regjistrin statistikor të ndërmarrjeve të vitit 2018, i cili përmban të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet, aktivitetet ekonomike të të cilave kontribuojnë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (P.B.B).




Shqipëria në Shifra



Publikimi “Shqipëria në Shifra, 2018” paraqet në mënyrë sintetike të dhëna statistikore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Botimi përmban 19 kapituj: Popullsia, Buxheti i Familjeve, Shëndetësia, Statistikat e Krimeve, Arsimi dhe Njohuritë, Kultura, Tregu i Punës, Çmimet, Llogaritë Kombëtare, Regjistri i Ndërmarrjeve, Tregtia e Jashtme, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikacionit, Mjedis – Mbetjet, Mjedis, Peshkimi, Mjedis – Biodiversitet, Bujqësia – Pyjet, Transporti, Turizmi.

Burrat dhe Gratë në Shqipëri, 2019

Kapitujt e përfshirë në këtë botim, pasqyrojnë fusha të ndryshme të të dhënave me bazë gjinore, të mbledhura nga anketat e zhvilluara nga INSTAT si dhe nga informacioni që disponojnë institucionet e tjera shtetërore në vend. Qëllimi kryesor i publikimit është të paraqesë të dhëna të ndara sipas gjinisë, duke synuar që statistikak jo vetëm të mblidhen, analizohen dhe prezantohen sipas gjinisë, por dhe të reflektojnë problematikat të shoqërisë për monitorimin e politikave ndërsektoriale në kuadër të arritjes së barazisë gjinore. Ky publikim këtë vit vjen para publikut me një informacion më të plotë mbi statistikak gjinore në vendin tonë si dhe disa risi lidhur me to. Janë paraqitur për herë të parë në mënyrë më të detajuar, të dhënat gjinore për shëndetësinë, nga anketa demografike e shëndetit, si duhani, alkooli, indeksi i masës trupore, konsumi i zarzavateve dhe frutave, etj.



Tregtia e Jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet 2018

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare. Statistikat mbi tregtinë e mallrave përmbajnë të dhëna mbi eksportet/importet e mallrave në Shqipëri, si edhe statistika të tregtisë së mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

Tregu i Punës, 2018

Statistikat e tregut të punës në Shqipëri bazohen në dy burime kryesore, anketat dhe të dhënat administrative. Anketa e Forcave të Punës (AFP) është një vërtetim statistikor i vazhdueshëm i cili mbledh informacion cilësor dhe sasior për vlerësimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të gjithë individët 15 vjeç e lart në Shqipëri.

95 VJET
STATISTIKA
SHQIPËRE

INSTAT



Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri




Ky vërtetim u krye nga INSTAT me ekspertizën teknike të Dr. Robin, konsulente ndërkombëtare, edhe shkrimi i tij u kryesua nga Robin Haarr, me mbështetjen e UNDP-së dhe UN Women dhe me ndihmën financiare të Qeverisë së Australisë, në kuadër të projektit rajonal për statistikat gjinore dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm “Të bëjmë që çdo grua dhe vajzë të ketë rëndësi” dhe të Qeverisë Suedeze në kuader të Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri. Opinione dhe mendimet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e UNDP-së, UN Women dhe donatorëve të tyre.

Sustainable Development Goals – SDG


Ky botim është publikuar për herë të parë nga INSTAT. Zhvillimi i qëndrueshëm ka qenë në qendër të politikës evropiane për një kohë të gjatë, të vendosur në Traktatet Evropiane.

Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015, i japin një shtysë të re përpjekjeve globale për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.




Kërkesat e përdoruesve

Databaza e përdoruesve u krijua për herë të parë në vitin 2009. Mbi bazën e kësaj databaze INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të kësaj databaze, mund të themi që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme që nga viti 2012, ndërsa në vitin 2016 pati një rënie të numrit të kërkesave nga përdoruesit nga 729 (2015) në 509 (2016). Në vitin 2019, numri i kërkesave të përdoruesve është 918 kërkesa, nga 1009 kërkesa që ka patur në vitin 2018 (91 kërkesa më pak).

Figura 6: Numri i kërkesave të përdoruesve 2015 – 2019

Duke e thelluar analizën e statistikave të plotësimit të kërkesave të përdoruesve, vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve, në vitin 2019 është ulur, duke arritur shifrën 918 kërkesa, nga 1009 kërkesa në vitin 2018. Në vitin 2019 kemi një ulje të kërkesave me 9.0 %, kundrejt vitit 2018. Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave mund të themi që numrin më të madh të tyre e zënë kërkesat e statistikave të çmimeve me 40.5 % të totalit të kërkesave, duke u pasuar nga kërkesat e statistikave sociale me 22.2 % të totalit të kërkesave, të dhëna nga statistika e tregtisë së jashtme me 7.4 % të totalit të kërkesave.

Figura 7: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore



Numrin më të madh të kërkesave të plotësuar në vitin 2019 e zënë statistikat e çmimeve me 372 kërkesa, pasuar nga statistikat sociale për popullsinë me 110, si dhe statistikat e tregtisë së jashtme me 68 kërkesa, etj. Një pasqyrë më të hollësishme mund ta konsultoni në tabelën e mëposhtme:

Tabela 10: Numri i kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore


Lënda e Kërkesës	Numri i kërkesave 2018	Numri i kërkesave 2019	Ndryshimi në përqindje 2018 - 2019	Përqindja ndaj totalit 2019
Çmimet	385	372	-3.38	40.5
Bujqësia dhe Blegtoria	11	14	27.3	1.5
Tregtia e jashtme	69	68	-1.5	7.4
ASN	2	14	600	1.5
Ndërmarrjet	31	46	48.4	5.0
Llogaritë kombëtare	43	30	-30.2	3.3
Popullsia/lindjet-vdekjet/martestat/divorcet/emigracioni	83	110	32.5	12.0
Ndërtimi	4	5	25	0.5
Shkaqet e vdekjeve /shendetesia	16	19	6.25	2.1
Punësimi/papunesia/pagat	49	54	10.2	5.9
Turizmi/transporti/aksidentet	30	58	93.3	6.3
Konsumi i familjeve /niveli jeteses / shpenzimet e familjes	51	74	45.1	8.1
Të tjera/të ndryshme/Të dhëna të 2 ose më shumë fushave statistikore/ Pyetësor të ndryshëm	235	54	-77	5.9
Totali	1009	918	Rënie me 91 kërkesa	100

Rrjeti Social Facebook

Gjatë vitit 2019, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 5.705 pëlqime nga 5.252 pëlqime në 2018. Ku numri më i madh u arrit gjatë muaji Dhjetor 2019.




Nga numri total i pëlqimeve, 57 % janë femra dhe 42 % janë meshkuj. Grup moshë me aktive në faqen e INSTAT është 25-34 vjeç, nga të cilët 31 % janë femra dhe 24 % janë meshkuj.



Shikueshmëria e positimeve gjatë vitit 2019 ka qenë 223.919, e cila e ndarë sipas periudhave katër mujore tregon periudhën me shikueshmëri më të lartë.

Janar-Prill – 88.775, Maj-Gusht – 70.087, Shtator-Dhjetor – 65.057.

Shikueshmëria më e lartë e faqes është në orën 12:00.



Postimet

Numri total i postimeve nga data 1 Janar 2019 - 31 Dhjetor 2019 është 95 postime postime të cilat kanë arritur një shikueshmëri prej 189.509 personash me një mesatare 2.256 për çdo postim. Shikueshmëria e faqes ka kapur numrin më të madh në muajin Dhjetor 2019. Postimet në faqe janë të bazuara në kalendarin e eventeve të facebook (duke respektuar kalendarin e publikimeve të INSTAT), i cili përmban datat e daljes së publikimeve dhe eventeve të tjera të rëndësishme.

Statuset të cilat kanë pasur shikueshmërinë më të lartë janë:



1-Konferenca hapëse “Censi i Popullsisë dhe Banesave 2020”

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=2340366969380035&id=590804097669673 -

9.313 Shikime



2-“Open Day – Dita Evropiane e Statistikave”

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=2397535880329810&id=590804097669673 - 8.864 Shikime



3-Përzgjidhet Logo e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=2098617560221645&id=590804097669673 - 7.363

Shikime



APLIKIME PËR PROGRAMIN MASTER SHKENCOR NË STATISTIKË ZYRTARE (120 KREDITE)

Nevija për të siguruar që sistemet statistike kombëtare të jenë në gjendje të prodhojnë të dhëna të prodhuesve, të besueshme, që përmbledhojnë standardet e vlerave profesionale dhe shkencore të bashkëpunimit. Prodhimi i statistikave angazhuar, transparente dhe të shprehura, ndihmon në zgjidhjen e problemeve më proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale. Brenda vendit dhe jashtë krahut kaqsi me vendet e tjera. Në këto kushte, nevoja që sistemi universitar publik të ofrojë në mënyrë sistematike një kurs masteri shkencor në fushën e Statistikave Zyrtare është i kërkuar.

Masteri Shkencor në Statistikë Zyrtare ofrohet nga bashkëpunimi i Institutit të Statistikave në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë, Universitetin e Tiranës dhe përbën një eksperiment unik për të marrë edukim në fushën e statistikave zyrtare për profesionistët dhe jo vetëm.

Për hapjen e këtij programi studi, INSTAT dhe Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës janë mbledhur tek përvojat në të njëjtën si dhe universitetet e huaja të cilat ofrojnë programe të ngjashme studi.

Ky propozim lindi si ide nga bashkëpunimi me EUROSTAT, në kuadër të përfaqësimit në projektin EMOS (European Master in Official Statistics) i cili ofron programe studi nga universitetet e vendeve të tjera. Në këtë ofrime Masteri studi në Statistikë Zyrtare, si dhe INSTAT, i cili ofroi një nga prodhimet kryesorë për studentët e Fakultetit të Ekonomisë, UT.

4- Aplikime për programin master shkencor në statistika zyrtare (120 kredite)

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=2021272277956174&id=590804097669673&substory_index=0 - 6.690 Shikime

Mbulimi mediatik

Përmendja dhe citimi i INSTAT gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 është vërejtur gjithsej 2,870 herë (gjatë vitit 2018 numri i përmendjeve ishte 3.686 herë) në përmbajtjen e 1,644 artikujve të botuar në shtypin shqiptar, ndërkohë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme rezultojnë 53 përmendje. Dhjetor dhe sasia më e lartë e përmendjeve vërehet në gazetën “Standard” “Telegraf” dhe “Albanian Daily News”.

Në edicionet kryesore të lajmeve të 9 TV-ve kryesore shqiptare përmendja dhe citimi i INSTAT, është vërejtur gjithsej 494 herë në përmbajtjen e 315 kronikave të transmetuara në 9 TV kryesore. Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në muajin Maj dhe Shtator dhe sasia më e madhe e përmendjeve vërehet në TV Scan.

Përmendja dhe citimi në portalet online është vërejtur 7,516 herë në përmbajtjen e 6,611 artikujve. Frekuenca më e lartë e përmendjeve është regjistruar në muajin Maj dhe sasia më e lartë e përmendjeve vërehet në portalin “monitor.al”.

Gjatë vitit 2019, përmendja dhe citimi i INSTAT në **web portalet e monitoruara** është vërejtur 10.306 nga 6.975 që ishte një vit më parë, duke i renditur i dyti në rang institucionesh, pas Bashkisë së Tiranës.

Tabela 11: Frekuenca krahasimore e përmendjes dhe citimeve të institucioneve shtetërore në ëeb portalet e monitoruara

Institucionet	2019	2018	2017	2016
1. Bashkia Tiranë	20.575	6.975	7.140	1.840
2. INSTAT	10.306	6.773	3.676	1.784
3. Banka e Shqipërisë	8.812	5.939	2.682	1.066
4. MF	4.399	2.915	2.054	221
5. KM	2.618	2.294	1.331	118
6. Ministria e Bujqësisë	1.687	1.566	845	36

Tabela 12: Shpërndarja kronologjike e përmendjes dhe citimeve të INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019

Date	Standard	Telegraf	Albanian Daily News	Revista Monitor	Sot	Tema	Dita	Koha Jone	Gazeta Shqiptare	Tirana Times	Shekulli	Gazeta Mapo	Shqiptarja	Panorama	Gazeta Liberale	Panorama Sport	Gazeta Nacional	Grand Total
Jan 2019	17	32	19	46	9	10	15	4	3	9	15	8	5	5				197
Feb 2019	43	31	23	55	27	17	26	9	19	6	19	10	7	9				301
Mar 2019	43	54	23	44	25	26	39	13	15	27	15	19	19	3				365
Apr 2019	29	35	22	25	10	10	7	10	8	9	14	2	3	1	1			186
May 2019	71	60	41	10	21	35	17	30	24	9	23	16	10	6				373
Jul 2019	58	32	39	39	31	17	25	29	28	30	7	8	8	5	1			357
Sep 2019	61	35	42	43	33	28	17	21	21	18	29	11	12	4				375
Nov 2019	39	19	12	32	20	21	12	12	17	15	11	11	4	6	2			233
Dec 2019	65	60	117	41	43	19	24	22	14	19		17		23	16	1	2	483
Grand Total	426	358	338	335	219	183	182	150	149	142	133	102	68	62	18	3	2	2,870

Tabela 13: Shpërndarja sipas rubrikave e përmendjes dhe citimeve të INSTAT sipas gazetave të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019

Rubrikat	Albanian Daily News	Dita	Gazeta Shqiptare	Panorama	Revista Monitor	Shekulli	Shqiptarja	Sot	Standard	Telegraf	Tema	Tirana Times	Gazeta Mapo	Panorama Sport	Koha Jone	Gazeta Liberale	Gazeta Nacional	Grand Total
(blank)	17	4	3		13			8	12	15	4	7	1		3			87
Aktualitet - Current			2							4	1			2				9
Ekonomi - Economy	229	111	95	12	299	52	43	112	146	143	53	88	48		8	9		1,448
Kronikë - Chronicle		8	2	9		2	2	10	24	1	8		4		36			106
Kulturë - Culture	10	1	2	5		1		24				2	1		6		2	54
Miscellaneous	7	1	2			6			21	7	3	2	3			2		54
Ndërkombëtare	5	3			2	1		2			3					1		17
Politikë - Politics	13	7	15	23	2	10	6	24	69	30	17	4	15		29	1		265
Shëndeti - Health										3								3
Sociale - Social	56	47	28	13	19	61	17	37	154	155	94	39	29		69	2		820
Sport	1							2					1	3				7
Grand Total	338	182	149	62	335	133	68	219	426	358	183	142	102	3	150	18	2	2,870

Tabela 14: Parametra të artikujve ku përmendet INSTAT sipas gazetave dhe televizioneve të monitoruara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019

PRINT	Përmendje	Artikuj	Sipërfaqe publikimi
Albanian Daily News	338	202	40,095
Dita	182	103	34,665
Gazeta Mapo	102	54	18,523
Gazeta Shqiptare	149	89	20,162
Panorama	62	36	11,068
Revista Monitor	335	179	93,096
Shekulli	133	98	16,359
Shqiptarja	68	38	8,078
Sot	219	130	16,204
Standard	426	226	80,764
Telegraf	358	196	68,207
Tema	183	107	28,969
Tirana Times	142	87	28,731
Panorama Sport	3	3	423
Koha Jone	150	84	25,919
Gazeta Liberale	18	11	3,382
Gazeta Nacional	2	1	736
Grand Total	2,870	1,644	495,381

Tabela 15: Shpërndarja kronologjike e përmendjeve të INSTAT në faqet e para të gazetave gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019

Date	Standard	Telegraf	Albanian Daily News	Shekulli	Tema	Gazeta Mapo	Tirana Times	Gazeta Liberale	Gazeta Shqiptare	Dita	Grand Total
Jan 2019		1						1			2
Feb 2019	2		2		1				1		6
Mar 2019	2		1								3
May 2019	4	3	1	1	1	1					11
Jul 2019	4				1	1					6
Sep 2019	5		3	1		2		1			12
Nov 2019	2										2
Dec 2019	1	3	5				2				11
Grand Total	20	7	7	6	3	3	2	2	2	1	53

Tabela 16: Shpërndarja kronologjike e përmendjeve dhe citimeve të INSTAT, sipas TV-ve për periudhën Janar-Dhjetor 2019

Date	TV SCAN	TV TOP CHANNEL	TV ORA NEWS	TV KLAN	TV NEWS 24	TV A1 Report	TV ABC News	TV VIZION +	TVSH	TV VIZION PLUS	TV Fax News	Grand Total
Jan 2019	12	4	1			3	1					21
Feb 2019	32	4	9	2	12	5	6	2	1			73
Mar 2019	23	14	6		4	2		8	4		1	62
Apr 2019	11	3	3	4								21
May 2019	30	19	13	10	5	5	3			4		89
Jul 2019	21	7	3	6	1		4		1	1		44
Sep 2019	43	16	2	8	2		5		1	1		78
Nov 2019	20		1	2								23
Dec 2019	62		7	6	4	4						83
Grand Total	254	67	45	38	28	19	19	10	7	6	1	494

Tabela 17: Frekuenca krahasimore e përmendjes dhe citimeve të institucioneve shtetërore në gazetatat e monitoruara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019

Nr.	Institucione	Albanian Daily News	Dita	Gazeta Shqiptare	Panorama	Revista Monitor	Shekulli	Shqiptarja	Sot	Standard	Telegraf	Tema	Panorama Sport	Gazeta Mupo	Tirana Times	Koha Jone	Ekonomia	Gazeta Liberale	Gazeta Nacional	Grand Total
1	Prokuroria	795	3,554	3,138	4,424	80	2,433	2,672	7,788	2,695	1,488	2,235	40	1,531	22	2,532		573	25	36,003
2	Kuvendi Parlamentar	388	1,229	1,781	1,619	100	983	751	3,528	1,089	1,428	1,623	66	629	12	1,611		338	20	17,195
3	Gjykata Kushtetuese	516	1,115	1,299	1,565	83	557	384	4,063	1,265	1,559	1,400	96	360	124	1,694		513	23	16,586
4	Banka e Shqiptare	923	203	269	166	363	75	90	642	187	329	114		58	253	41	3	23	3	3,742
5	Kontrolli i Lartë Shtetit	65	187	176	147	95	163	83	1,450	277	417	118	4	74	20	139		4		3,417
6	INSTAT	338	182	149	62	335	133	68	219	426	358	183	3	102	142	150		18	2	2,870
7	MF	180	132	243	141	146	133	89	271	180	224	72	5	32	49	43		19	5	1,944
8	Bashkia e Tiranës	176	180	139	125	26	116	114	138	109	96	50	3	29	10	401		11	5	1,728
9	Ministria e Mbrojtjes	57	144	159	143	10	54	28	222	89	193	139	4	36		141		16	5	1,440
10	ALLIUNZI	21	50	171	117	12	196	102	480	33	132	21		27	3	32		14	1	1,412
11	OSHEE	160	70	88	43	234	76	48	111	129	173	26	4	18	24	33				1,217
12	QSHUT	72	119	96	62	11	99	60	73	91	153	31		35	3	195		2		1,102
13	Ministria e Punëve të Jashtme	10	83	130	90	4	70	53	154	59	87	103	2	31	1	121		7	1	1,006
14	KESH	80	65	42	47	77	67	19	88	64	65	51	3	27	22	24		2	1	744
15	Avokati i Popullit	9	34	72	37	21	47	10	140	58	63	36		64		54		3		648
16	OST	93	77	26	43	34	53	34	47	39	46	2		48	32	24		19		617
17	KLD	4	35	18	35		26	120	268	15	15	41		9		15		1		602
18	KM	26	64	52	43	2	51	53	83	30	35	39		11	2	89				580
19	KLSH	6	43	33	23	21	25	10	187	47	73	14		15	1	15		2		515
20	Ministria e Shëndetësisë	5	51	56	31	10	26	21	45	34	55	16		7		92		5		454
21	Ministria e Bujqësisë	57	18	31	22	40	24	13	55	23	58	33		6	18	23		4		425
22	ILDKP	7	15	20	25		25	37	201	6	6	44		1		7				394
23	Posta Shqiptare	6	30	29	34	7	16	28	42	16	28	9		4		38		1		288
24	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit	13	17	40	26	30	12	5	27	13	32	8		7		19				249
25	AMF		11	28	10	43	5	9	26	15	20	4		4		2				177
26	AZHB	20	1	16	2	23	4	3	5	3	3	10				3				93
27	Dogana			14	5	3	3	7	7	5	7	2		2		1				56
28	SHSHB	1		4	1	3	3	1	4	2	12					1				32
29	Grand Total	4,028	7,709	8,299	9,088	1,793	5,475	4,912	20,364	6,969	7,133	6,422	230	3,167	738	7,540	3	1,573	93	95,536

Statistikat e website të INSTAT

Me përjashtim të temës “Çmimet”, të gjitha temat kryesore të faqes së INSTAT paraqiten me rritje. Në tabelën më poshtë janë të renditura për nga numri i shikimit dhe ndryshimi në përqindje nga 2017 në 2019.

¹Pageviews – Shikimi i faqeve është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikime

Tabela 18: Page views sipas temave kryesore 2017 - 2019

Tema	Total 2017	Total 2018	Total 2019
Shkencë Teknologji dhe Shoqëria Dixhitale	972	5,189	7,548
Çmimet	6,202	41,263	31,879
Bujqësia dhe Peshkimi	3,418	18,800	26,622
Statistikat e Përgjithshme dhe Rajonale	2,612	13,961	16,399
Tregtia e Jashtme	3,357	17,891	22,508
Kushtet Sociale	5,105	25,463	42,049
Tregu i Punës dhe Arsimi	14,266	61,446	114,113
Censet	3,697	14,936	19,050
Mjedisi dhe Energjia	5,053	11,921	14,725
Industria Tregtia dhe Shërbimet	29,469	68,291	74,284
Ekonomi dhe Financë	73,165	79,014	83,394
Treguesit Demografikë dhe Socialë	64,233	100,697	133,713

Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimi Evropian

INSTAT u krijua si institucion i mirëfilltë statistikor në vitin 1993, në periudhën kur populli shqiptar dhe institucionet që e përfaqësojnë synonin krijimin e sistemit pluralist dhe demokratik, të ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Perëndimore. Ligji i vitit 1993 për statistikën zyrtare ishte hapi i parë në këtë drejtim për ndërtimin e infrastrukturës institucionale të prodhimit statistikor.

Në vitin 2004, në kohën kur Komisioni Evropian kishte dhënë rekomandimin për hapjen e negociatave për nënshkrimin e MSA-së dhe ishin hapur zyrtarisht bisedimet për nënshkrimin e saj, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri për statistikën zyrtare, duke e pozicionuar INSTAT si institucionin kryesor statistikor në vend si dhe duke vendosur standarde të reja në lidhje me respektimin e parimeve statistikore, proceset e programimit e raportimit si dhe organet drejtuese e raportuese të performancës së tij.

Në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), në vitin 2006, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2007-2011, dokumenti i parë i këtij lloji i cili parashikonte veprimtarinë zhvillimore të statistikave zyrtare në terma afatgjata, si dhe angazhimit e përgjegjësitë e të gjitha institucioneve publike të përfshira, prodhuese apo ofruese të të dhënave.

Neni 88 i MSA-së shpreh vullnetin e palëve për bashkëpunim statistikor me qëllim që të ndërtohet një sistem i qëndrueshëm statistikor, i aftë të prodhojë të dhëna objektive dhe të sakta për të matur performancën e shtetit shqiptar dhe ecurinë e reformave të ndërmarra. Gjithashtu, në këtë nen shprehet angazhimi për ngritjen e një sistemi që respekton parimet themelore të statistikave të Kombeve të Bashkuara, Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe që zhvillohet drejt standardeve të Acquis Communautaire.

Në kuadër të integrimit, INSTAT, si institucioni përgjegjës për Kapitullin 18, ka ndërmarrë hapa konkretë drejt përafrimit të acquis që përfshihen në këtë kapitull. Për arritjen e suksesshme në këtë drejtim, INSTAT dhe shteti shqiptar në tërësinë e tij, ka gjetur mbështetjen dhe bashkëpunimin domethënës nga Eurostat dhe institucionet e tjera kombëtare statistikore të vendeve anëtare. Bashkëpunimi është konkretizuar kryesisht në fushën e monitorimit të ecurisë së zhvillimit statistikor nëpërmjet proceseve vlerësuese Peer Review, Sectoral Peer Review, dhënies së rekomandimeve periodike të Komisionit Evropian, mbështetjes për aktivitete të vecanta statistikore nëpërmjet projekteve CARDS dhe IPA, etj.

Nga momenti i hyrjes në fuqi të MSA-së, janë përmbushur një sërë rekomandimesh të Komisionit Evropian dhe Eurostatit, ku më kryesoret janë ndërhyrjet që duhet të bëjë shteti shqiptar për forcimin e pavarësisë profesionale të stafit të INSTAT dhe agjencive të tjera statistikore, emërimin e drejtorit të Përgjithshëm nëpërmjet procedurave publike, transparente e profesionale, rritjen e hierarkisë institucionale të INSTAT për pagesa motivuese dhe autonomi në menaxhimin e burimeve si dhe prodhimin e statistikave zyrtare sipas standardeve të rekomanduara. Në këtë kuadër, Ligji nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare” mundëson përafrimin e plotë me standardet kryesore që përcakton Rregullorja (KE) 223/2009, e ndryshuar, në lidhje me:

- Parashikimin e parimeve statistikore në përputhje me atë të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane;
- Ngritjen e institucionit të Drejtorit të Përgjithshëm si personi përfaqësues i Sistemit Kombëtar Statistikor, pavarësia profesionale e të cilit garantohej me ligj;
- Caktimin e Drejtorit të Përgjithshëm si personi i vetëm përgjegjës për të vendosur mbi proceset, metodat, procedurat dhe standardet e prodhimit të statistikave nga INSTAT si dhe për të nxjerrë udhëzime për zbatimin e parimeve të statistikave zyrtare nga prodhuesit e sistemit;
- Përcaktimin e standardeve për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm nëpërmjet procedurave transparente, të pazuara në kritere profesionale;
- Ndërtimin e një marrëdhënie efikase ndërmjet INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë për të respektuar statusin e vecantë ligjor në lidhje me pavarësinë institucionale;
- Forcimin e mandatit të prodhuesve të statistikave zyrtare për të drejtën e hyrjes në të dhënat administrative;
- Hartimin e Programit të Statistikave Zyrtare në terma afatgjata, duke parashikuar objektivat strategjike të zhvillimit statistikor;
- Hartimin e Planit Vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare;
- Sigurimin e parimit të konfidencialitetit statistikor.

Në kuadër të Procesit të Integritimit Evropian , në datat 12 dhe 13 shkurt 2019 në Luksemburg u zhvillua takimi shpjegues i acquis për kapitullin 18 "Statistikat". Delegacioni shqiptar u kryesua nga ish Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT Znj. Delina Ibrahimaj. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësuesit e MEPJ, misioni ynë në Bruksel përfaqësuar nga Znj Suela Janina, Ambasadore dhe stafi i saj si dhe 13 përfaqësues nga Instituti i Statistikave, 2 përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe 2 përfaqësues nga Banka e Shqipërisë. Për palën evropiane, takimi kryesohej nga Z. Marc Jorna, kryetar i Task Forcës për shqyrtimin analitik të acquis me Shqipërinë dhe Maqedoninë në DG NEAR.Nga pala shqiptarë u bë një prezantim i

shkurtër mbi situatën aktuale të përafrimit të *acquis* dhe u evidentuan arritjet e deritanishme, ndërsa problematika nuk u parashtruan. Pala evropiane shprehu vlerësim të kënaqshëm lidhur me ecurinë e takimit shpjegues, pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e delegacionit shqiptar në këtë takim.

Në përfundim të takimit, kryetari Z. Marc Jorna, shprehu rëndësinë e kapitullit 18 duke theksuar që pa mbarëvatjen dhe mirëfunksionimin e tij, nuk mund të funksionojë sic duhet zhvillimi i një vendi në aspektin ekonomik dhe social. Statistika më të mira, vendimarrje më e mirë.

Gjithashtu INSTAT ka dërguar përfaqësuesit e tij në takimet shpjeguese të kapitujve të tjerë negociues ku INSTAT kontribuon me ekspertizën e tij.

Në vijim të këtij takimi, INSTAT ka vijuar punën për zbatimin e planit të hapave kyc për takimin bilateral, duke përgatitur të gjithë materialet dhe dokumentat e nevojshme ashtu sikurse kërkohet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr.94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstytucionale të punës për integrimin Evropian”, përvec angazhimit për përmblidhjen e detyrimeve si institucioni përgjegjës për Kapitullin 18, Statistikat INSTAT ka ngritur grupin ndërinstytucional të punës për integrimin Evropian, si dhe është angazhuar në furnizimin me informacionin e duhur statistikor të të gjithë kapitujve të tjerë të *acquis*. Për këtë qëllim, cdo grup ndërinstytucional ka në përbërje të tij edhe dy anëtarë përfaqësues të INSTAT-it, sipas fushës përkatëse.

Në ndjekje të urdhrit të Kryeministrit nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për Integrimin Evropian”, urdhër që erdhi si kërkesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, ku përcaktohet struktura shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave pjesë e së cilës është dhe Platforma e Partneritetit, INSTAT ftoi për pjesëmarrje nëpërmjet një procesi transparent të njoftimit publik, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të tjera të interesit për tu bërë pjesë e tryezës për Kapitullin 18 “Statistikat”. Anëtarët e përzgjedhur u njoftuan dhe do të ftohen për të qënë pjesë e takimeve për Kapitullin 18.

Në zbatim të urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen e funksionimin e mekanizmit

sektorial/ndërsektorial të integruar”, INSTAT si lider i Grupit Tematik Statistikat, ka organizuar takimet e parashikuara në kalendarin e Integruar.

Zbatimi i rekomandimeve të BE-së dhe Eurostat

a) Progres Raporti i BE për Shqipërinë 2019

INSTAT është përgjegjës për kapitullin 18 “Statistikat. Kapitull, i cili paraqet Acquis të BE-së në fushën e statistikave që zbatohen nga çdo aktor i përfshirë në Sistemin Kombëtar të Statistikave në Shqipëri me qëllim përmirësimin e infrastrukturës statistikore të bazuar në parime si paanshmëria, besueshmëria, transparencja, ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave individuale dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare.

Progres raporti 2019, i Komisionit Evropian për Shqipërinë, thekson se Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar për statistikë. Është bërë një përparim në shumë fusha statistikore me miratimin e Ligjit të Ri për Statistikat Zyrtare. Është forcuar roli i Sistemit Kombëtar të Statistikave (INSTAT) megjithatë metodat e mbledhjes së të dhënave duhet të modernizohen dhe proceset statistikore të prodhimit duhet të përmirësohen. Rregullat e Bashkimit Evropian për Statistikat, kërkojnë që Shtetet Anëtare të jenë në gjendje të prodhojnë statistika bazuar në pavarësinë profesionale, paanshmërinë, besueshmërinë, transparencën dhe konfidencialitetin.

Si rekomandime për ardhmen, raporti thekson që Shqipëria duhet të fokusohet në veçanti në fushat në vijim:

- forcimin e burimeve të INSTAT
- plotësimin e vendeve vakante;
- zbatimin e Ligjit të Ri të statistikave zyrtare dhe zgjerimin e fushës së statistikave zyrtare në përputhje me legjislacionin e BE-së; përmirësimin e komunikimit me përdoruesit dhe palët e tjera të interesuara.

Sa i përket infrastrukturës statistikore, korniza ligjore është në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane dhe klasifikimet janë në përputhje me standardet e BE-së.

Ligji i ri hyri në fuqi në maj 2018, duke ndryshuar statusin juridik të INSTAT në atë të një institucioni të pavarur që raporton drejtpërdrejt në Parlament. Ai forcoi rolin dhe funksionet e sistemit kombëtar të statistikave, përmirësoi koordinimin dhe ndryshoi rolin dhe përbërjen e Këshillit të Statistikave. Sidoqoftë, sfera e statistikave zyrtare duhet të ripërcaktohet për të

përfshirë të gjitha statistikat evropiane dhe për të përmirësuar qasjen në statistikat zyrtare shtesë.

Të udhëhequr nga objektivi strategjik “Fuqizimi i rolit të INSTAT si një pjesëtar aktiv në sistemin statistikor në vend, në rajon dhe në arenën ndërkombëtare”, INSTAT ka vijuar me angazhimin e tij në paraqitjen e raporteve, mendimeve e studimeve në arenën ndërkombëtare në fushën e prodhimit dhe zhvillimit statistikor duke marrë pjesë dhe kontribuar në forume dhe aktivitete të ndryshme botërore të statistikave.

Në lidhje me këtë, vlen të theksohet se INSTAT ka mbajtur komunikime të vazhdueshme me Eurostat, organizata ndërkombëtare si UN, UNECE, EFTA, OECD, PARIS 21, si dhe institucione ndërkombëtare homologe mbi mbështetjen dhe monitorimin e aktivitete të ndryshme statistikore, në kuadër të zhvillimeve të reja dhe me të fundit në fushën e statistikave.

Kështu, në Komisionin Statistikor të Kombeve të Bashkuara organizuar në muajin Mars 2019, Drejtori i Përgjithshëm, ka mbajtur fjalën dhe pasqyruar qëndrimin e INSTAT në lidhje me përmirësimin e cilësisë statistikore, zbatimi i Agjendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Migrimi etj.

INSTAT që prej muajit Qershor 2019, është anëtar i Grupit të Nivelit të Lartë për Partneritetpranë Kombeve të Bashkuara, për koordinim dhe ndërtimin e kapaciteteve për statistikat për Axfordën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (HLG-PCCB.) Takimi i parë si anëtar i këtij grupi u zhvillua në muajin Nëntor 2019, në Budapest, ku INSTAT u angazhua gjithashtu për të qënë anëtar në nën-grupin i cili do të përgatisë draftin e parë të dokumentit I cili do të prezantohen në përfundim të Forumit Botëror të të Dhënave të Kombeve të Bashkuara (UNEDF) që pritet të zhvillohet në Bern nga data 18 deri më 21 tetor 2020. Nën-grupi përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm : Shqipëria, Angola, Meksika, Palestina, Filipinet, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, PARIS21 dhe UNSD.

Ndër synimet kryesore të INSTAT për vitin 2020, në lidhje Integrimin Evropian është të mbajë në mënyrë të vazhdueshme kontaktet me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Eurostat, institucionet homologe, institucione të tjera dhe organizatat ndërkombëtare me të cilat INSTAT bashkëpunon dhe me njësitë e Integrit Evropian në ministritë e linjës.

b) Progres-raporti i zbatimit të rekomandimeve të Peer Review për periudhën 2018-2019

Raporti i Peer Review parashikon 24 rekomandime, të operacionalizuara në 53 aktiviteteve zbatuese-përmirësuese. Afati i realizimit të këtyre aktiviteteve shtrihet në periudhën kohore

2018-2022. Për vitin 2018 ishte parashikuar realizimi i 15 aktiviteteve, për 4 nga të cilat afati i realizimit u shty për vitet 2020 dhe 2021. 23 aktivitete zbatuese ishin parashikuar për tu realizuar gjatë vitit 2019, ku për 9 prej tyre është shtyrë afati i realizimit për vitet 2020, 2021 për arsye të ndryshimeve strukturore të INSTAT si dhe sepse një pjesë e aktiviteteve varej nga institucionet e tjera publike. 6 aktivitete janë parashikuar për tu finalizuar në vitin 2020; 2 aktivitete në vitin 2021 dhe 1 aktivitet në vitin 2022. Monitorimi i zbatimit të aktiviteteve është kryer me periodicitet mujor, ndërsa është raportuar për zbatimin e tyre me periodicitet 3 mujor. Për periudhën 2018-2019, në kuadër të forcimit të mjedisit institucional janë kryer 12 aktivitete përmirësuese, që lidhen kryesisht me vizibilitetin e kalendarit të publikimeve, Raportit Vjetor mbi zbatimin e PSZ-së dhe me krijimin e Komitetit të Konfidencialitetit, Komitetit të Cilësisë dhe publikimin e politikave përkatëse. Ndërkohë 7 aktivitete janë në proces realizimi, pasi puna për realizimin e tyre është përfshirë në një plan të ri veprimi apo realizimi i tyre varet nga faktorë jashtë SKS.

Përsa i përket rekomandimit për zhvillimin e mëtejshëm të menaxhimit të cilësisë dhe përmirësisimit të raportit kosto-efektivitet janë realizuar 4 aktivitete, që lidhen me krijimin e udhëzimeve metodologjike për produktet statistikore, ngritjen e ekipit për vlerësimin e tyre, shtimin e indikatorëve të performancës etj. Ndërkohë vazhdon puna për realizimin e 19 aktiviteteve të tjera, të cilat janë në zbatim të vazhdueshëm, kanë shtyrje në afat apo puna për realizimin e tyre është përfshirë në një plan të ri veprimi.

Për të përmirësuar më tej komunikimin me përdoruesit apo aktorët e tjerë, janë realizuar 7 aktivitete, që kanë të bëjnë me vizibilitetin e veprimtarisë së Këshillit të Statistikave, krijimin e grupit të përhershëm të përdoruesve për fushat kyçe të statistikave apo me rritjen e ndërgjegjësimit në statistikat zyrtare, nëpërmjet zhvillimit të workshopeve dhe seminareve me gazetarët dhe mediat informative. Ndërkohë vazhdon puna për realizimin e 4 aktiviteteve që lidhen me forcimin e bashkëpunimit me botën akademike, bashkëpunim i cili tashmë ka nisur dhe në këtë kuadër është zhvilluar një takim prezantues me përfaqësues të universiteve publike dhe jo publike në Shqipëri. Gjithashtu, vazhdon puna për formalizimin e Grupit Akademik, funksionimit të tij, si dhe për substancializuar nismën e forcimit të bashkëpunimit dypalësh.


Në fund të Shtatorit 2019, Eurostat beri një vlerësim të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të Peer Review. Tabela më poshtë pasqyron nivelin e zbatimit të aktiviteteve përmirësuese sipas raportit të Eurostat.

Tabelë përmblledhëse mbi statusin e realizimit të aktiviteteve përmirësuese		
	Numri	%
Aktivitetet përmirësuese	53	100,0
Aktiviteti është realizuar	22	41,5
Puna po përparon sipas planit dhe nuk është përfunduar:	12	22,6
- është planifikuar të përfundojë në 2019	5	9,4
- është planifikuar të përfundojë në 2020	4	7,5
- është planifikuar të përfundojë në 2021	2	3,8
- është planifikuar të përfundojë në 2022	1	1,9
Puna po vazhdon pa një afat specifik	7	13,2
Progresi i mëtijshëm tani varet nga autoritete jashtë SKS	2	3,8
Ka patur vonesa brenda SKS	1	1,9
Puna ka qene e përfshirë në një plan të ri veprimi	9	17,0
- dhe afati i ri është viti 2020	7	13,2
- dhe afati i ri është viti 2021	2	3,8

Totali i aktiviteteve të realizuara në fund të vitit 2019 është 23, ndërsa për zërat e tjerë të tabelës, për periudhën reference, situata ngelet e njëjtë. Për periudhën 2020-2022 është planifikuar realizimi i 23 aktiviteteve, ndërsa për 7 aktivitete puna vazhdon pa ndonjë afat specifik.

Grafiku i mëposhtëm paraqet progresin e zbatueshmërisë së rekomandimeve dhe prespektivën në kohë të finalizimit të tyre.

Zbatimi i rekomandimeve të Peer Review



Grafiku i zbatimit të rekomandimeve të Peer Review për periudhën 2018-2019.

Koordinimi i Projekteve

Bashkëpunimi statistikor ndërkombëtar synon krahasueshmërinë e statistikave zyrtare me standardet e Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i bashkëpunimit statistikor ndërkombëtar është të forcojë Sistemin Statistikor Kombëtar duke përshtatur metodologjinë dhe praktikën me Acquis dhe duke i integruar ato në Sistemin Evropian të Statistikave. Bashkëpunimi ndërkombëtar i statistikave gjithashtu siguron mbështetje dhe asistencë në ndërtimin e kapaciteteve duke ndikuar në rritjen profesionale.

Një pjesë e konsiderueshme e zhvillimit të statistikave zyrtare është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruar nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat kombëtare statistikore të vendeve anëtare. Pjesa më e madhe e mbështetjes është ofruar nga asistencën e Bashkimit Evropian (BE), Sida (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar), Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave (FSO), Banka Botërore (BB), si dhe Kombet e Bashkuara (UN). Në vijim paraqitet informacion më i detajuar në lidhje me natyrën e mbështetjes.

Projektet me financime të ndryshme, të zbatuara në INSTAT gjatë vitit 2019, janë si më poshtë:

1. Projekti “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri”

Në kuadër të Programit IPA 2014, BE ka garantuar një mbështetje prej 4.8 milion euro për censin. INSTAT është përfitues i Grantit “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave, në Shqipëri”. Kontrata prej 1.46 milion Euro është prokuruar dhe nënshkruar ndërmjet INSTAT dhe Shoqërisë konsulente GOPA, ndërkohë që një marrëveshje zbatimi është nënshkruar ndërmjet INSTAT dhe CFCU, në rolin e Autoritetit Kontraktues, në datë 11 Dhjetor 2018.

Qëllimi i grantit është që të mbështesë INSTAT në kryerjen e aktiviteteve operative të Censit të Popullsisë dhe Banesave, në mënyrë që politikbërësit, qeverisja qendrore, ajo lokale dhe qytetarët e Shqipërisë të disponojnë dhe shfrytëzojnë statistika të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse mbi popullsinë rezidente të vendit. Në kuadër të kryerjes së këtij aktiviteti madhor, gjatë vitit 2019, INSTAT ka realizuar të gjitha aktivitetet e parashikuara sipas dokumentit strategjik dhe buxhetit të Cens-it. Një nga aktivitetet më të rëndësishme të fazës përgatitore, ishte kryerja e Pilotit të Cens-it i cili kërkoi një angazhim të konsiderueshëm të burimeve njerëzore dhe financiare. Qëllimi kryesor i Pilot është që të testojë në kushte reale hartografinë, metodologjinë, strukturën organizative, sistemin CAPI, planifikimin logjistik si dhe ndërveprimin midis të gjitha burimeve të planifikuara për t'u angazhuar në regjistrimin e popullsisë

Java përmbyllëse e pilotit të Censit përkoi me tërmetin e datës 26 Nëntor i cili ndikoi në fazën mbyllëse të pilotit, duke u shoqëruar kështu edhe me ndryshime metodologjike si pasojë e lëvizjes së popullsisë në zonat e afektuara nga tërmeti. Në bashkëpunim me asistencën teknike, në vazhdim INSTAT do të analizojë gjetjet e Pilotit të Censit si dhe pasojat e tërmetit në kryerjen e Censit.

2. Programi IPA Shumë-përfitues

Qëllimi i këtij programi është që të përgatisë autoritetet statistikore në vendet përfituese për anëtarësim në BE duke përafruar metodologjinë dhe praktikatat e tyre me kërkesat statistikore dhe integrimin e tyre në Sistemin Evropian të Statistikave.

Programi IPA Shumë-përfitues i bashkëpunimit statistikor siguron mbështetje dhe asistencë në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ekspertizës institucionale përmes pjesëmarrjes në kurset e trajnimeve dhe trajnimet afatgjata për periudhën 3 - 5 mujore në Institucionet Kombëtare të vendeve anëtare dhe në EUROSTAT, pjesëmarrja në takimet dhe grupet punës të Sistemit Statistikor Evropian.

Objekti i përgjithshëm i programit është përgatitja e autoriteteve statistikore në vendet përfituese të cilat synojnë anëtarësimin në BE, duke përshtatur metodologjitë dhe praktikën e tyre me acquis dhe duke i integruar ato në Sistemin Evropian të Statistikave. Në këtë kuadër synohet të përmirësohet disponueshmëria dhe cilësia e të dhënave statistikore në vendet përfituese, veçanërisht në fushat kryesore si: statistikën makroekonomike, statistikën e bujqësisë, statistikën sociale, statistika e ndërmarrjeve etj.

Mbështetja nga programi IPA shumë-përfitues i bashkëpunimit statistikor sigurohet nëpërmjet asistencës teknike specifike dhe ekspertizë për projektet pilote të ndryshme me qëllim përmirësimin e grumbullimit, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave cilësore.

Fushat e mbështetjes në kuadër të Programit IPA MB janë në statistikën makroekonomike (llogaritë kombëtare, llogaritë rajonale dhe sektoriale, statistikën e financave qeveritare, matja e fuqisë blerëse dhe indeksi i harmonizuar i çmimeve të Konsumit , procedura e disbalancës makroekonomike), statistikën sociale (të ardhurat dhe niveli i jetesës, forcave të punës, krimi dhe drejtësisë, anketë mbi dhunën mbi bazë gjinore), statistikën e ndërmarrjeve (tregtia e shërbimeve, regjistri i ndërmarrjeve, statistikën afatshkurtra, statistikën strukturore të ndërmarrjeve, kërkimi dhe zhvillimi.), statistikën bujqësore, llogaritë mjedisore dhe fushat statistikore me natyrë më horizontale (menaxhimi i cilësisë, metadatat dhe shkëmbimi i të dhënave etj) si dhe disa projekte statistikore ad-hoc.

3. Rritja e Kapaciteteve të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM – SMEI).

INSTAT është aktualisht në fazën e zbatimit të projektit "Rritja e Kapaciteteve të Inovacionit për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme". Kontrata ndërmjet Autoritetit Menaxhues (Greqi) dhe Shoqatës Kombëtare të Bizneseve të Vogla dhe të Mesme (Bullgari) është nënshkruar më 01.08.2017, me një kohëzgjatje prej 24 muajsh. Në këtë projekt, INSTAT ka rolin e partnerit të projektit dhe i gjithë komunikimi bëhet përmes partnerit kryesor Shoqatës Kombëtare të Bizneseve të Vogla dhe të Mesme, Bullgari.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të rrisë kapacitetin ndërkombëtar të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe t'i mbështesë ato në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm, duke përfshirë grupe inovative me NVM të tjera nga rajoni për të ndarë njohuritë dhe zhvillimin e inovacioneve.

Gjatë vitit 2019, janë realizuar disa aktivitete, të cilat kanë kontribuar në arritjen e objektivave kryesorë të projektit. Si e tillë, është edhe kryejra e Anketës së Inovacionit mbi Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në Dhjetor 2019, përpunimi i të dhënave, si dhe nxjerrja e rezultateve të anketës së Inovacionit mbi NVM-të, të cilat do të shërbejnë për krijimin e grupeve inovative me NVM të tjera në rajon, si dhe zhvillimin e inovacioneve, si bazë krahasimore me vendet e tjera, të përfshira në projekt. Gjithashtu, një aktivitetet shumë i rëndësishëm i këtij projekti ishte dhe organizimi i një Samiti “Innovation in Action” në 20 Qershor 2019, me tema kryesore politikat shtetërore për promovimin e inovacionit brenda NVM-ve, mekanizmat financiarë dhe mundësitë e financimit për produkte inovative, prezantimin e produkteve inovative të zhvilluara nga NVM-të si dhe praktikatat më të mira në zhvillimin e ideve dhe inovacioneve në fushën e TIK. Pjesëmarrës në këtë event ishin përfaqësues të sektorit të biznesit, NVM-të, Institucionet Shtetërore si dhe organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale në Statistika Faza e 5-të, Sida

Gjatë vitit 2019, ka qenë në zbatim faza e pestë e bashkëpunimit midis SCB dhe INSTAT, duke siguruar kështu një ndihmë të konsiderueshme në përmirësimin e metodologjisë statistikore, krijimin e infrastrukturës teknologjike të sistemit të përpunimit të informacionit statistikor, ofrimit të ekspertizës pranë INSTAT për fusha të ndryshme statistikore. Fushat prioritare të asistencës teknike gjatë gjithë fazës së projektit përfshijnë Menaxhimin, Metodologjinë dhe Prodhimin Statistikor, Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, ofrimit të ekspertizës pranë INSTAT etj. Gjatë vitit 2019, në kuadër të këtij projekti janë hartuar modulet përkatëse të trajnimit për komponentet e menaxhimit dhe të metodologjisë, është finalizuar zhvillimi i faqes së Intraneit, si dhe është ndërtuar sistemi i menaxhimit të Burimet Njerëzore..

5. Sida - Bashkëpunimi Rajonal në vendet e Evropës Juglindore

Gjatë vitit 2019 ka nisur puna për zbatimin e projektit “Bashkëpunimit Statistikor ndërmjet Institutit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë dhe Statistikave Suedeze – Sida Rajonale” financuar nga Statistikat Suedeze. Objektivi i projektit është zhvillimi sa më mirë i sistemeve statistikore në rajon në përputhje me legjislacionin e BE për statistikatat. Target grupi i projektit

janë Institucione Statistike të vendeve kandidate dhe potencial kandidate në BE të Ballkanin Perëndimor.

Fushat prioritare të asistencës teknike përfshijnë tre komponentë, të dhënat administrative dhe regjistrat, metodologjia e anketës, si dhe shkolla verore. Gjatë vitit 2019 janë realizuar disa aktivitete të cilat lidhen me komponentin e parë dhe të dytë, specifikiht seminare në lidhje me të dhënat administrative, si dhe kurset e Metodologjisë së Anketës.

6. Financim i drejtpërdrejtë në INSTAT për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e një qendre trajnimi

Gjithashtu, INSTAT, ka përfituar nga Sida edhe një projekt me përgjegjësi të plotë të menaxhimit të fondeve nga vetë INSTAT i cili ka mbuluar financiarisht prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e një qendre trajnimi. Nëpërmjet këtij projekti u bë e mundur blerja e pajisjeve IT, laptopë dhe kompjuter, si dhe u mundësua blerja e workstations dhe kompjuter desktop që do të lehtësojnë punën për kryerjen e Censit në Shqipëri. Projekti u mbyll me sukses në Qershor të vitit 2019.

7. Projekti Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare (SALSTAT)

SALSTAT-i është pjesë e programit “Bashki të Forta” financuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zvicerian për Zhvillim për periudhën Qershor 2017-Maj 2024. SALSTAT-i menaxhohet nga Zyra Statistike Federale Zviceriane dhe INSTAT në bashkëpunim me SDC.

Qëllimi kryesor i SALSTAT është vlerësimi i mundësive për të përmirësuar disponueshmërinë e statistikave në nivel lokal dhe rajonal. SALSTAT është bazuar në reformën Territoriale dhe Administrative (TAR) 2015. Projekti synon të krijojë një sistem statistikor (të dhëna dhe tregues) në nivel rajonal dhe lokal, veçanërisht për statistikën demografike dhe sociale. Vlerësimi përfshin gjithashtu kushtet për krijimin e mundshëm të Regjistrat Statistikor të Popullsisë, si dhe Regjistrat të Ndërtesave dhe Banesave në terma afatgjatë.

Gjatë vitit 2019, është punuar për identifikimin e listës së indikatorëve në nivel bashkie. Në kuadër të këtij projekti është bërë e mundur blerja e programit për përditësimin e hartave për Cens-in -. Gjithashtu, është zhvilluar edhe strategjia e komunikimit për zbatimin e projektit SALSTAT, si dhe është përgatitur plani i trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit në nivel bashkie mbi definicionet statistikore.

8. Projekti “Krijimi i një Strategjie për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në Shqipëri”

INSTAT është përfitues i projektit “Krijimi i një Strategjie për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor në Shqipëri”, financuar nga Banka Botërore. CFCU në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë është përgjegjës për aspektet financiare, ndërsa INSTAT është përgjegjës për zbatimin e projektit nga ana teknike.

Qëllimi i grantit është që të mbështesë INSTAT në përgatitjen e një strategjie kombëtare për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor për vitet 2019-2030, zhvillimin e planeve të veprimit afatmesëm dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të INSTAT-it për zbatimin e strategjisë.

Gjatë vitit 2019, projekti ka qenë në fazën e zbatimit, ku me qëllim krijimin e Strategjisë për Sistemin Kombëtar Statistikor, janë zhvilluar takime dhe ëorkshope me të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e draftimit të dokumentit strategjik dhe planit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë. Projekti u mbyll me sukses në Gusht 2019, duke finalizuar dhe ndërtimin e një Strategjie Kombëtare për Sistemin Kombëtar Statistikor.

Burimet njerëzore dhe financiare

Burimet Njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, identifikimin dhe trajnimin e tyre, duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe rritjes së vazhdueshme të performancës.

Në këtë kuadër, INSTAT ka ndërmarrë disa hapa dhe është në proces të vazhdueshëm të hartimit të politikave dhe strategjive që ndihmojnë në arritjen e objektivave institucionale dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve.

Në funksion të përmirësimit të rezultateve të kënaqësisë së punonjësve, INSTAT kryen anketën e kënaqësisë së punonjë

sve, si një strategji të vazhdueshme mbi analizën e faktorëve që ndikojnë në uljen apo rritjen e kënaqësisë së punonjësve dhe hartimin e planit të veprimit mbi rritjen e kënaqësisë së punonjësve.

Gjatë vitit 2019, në zbatim të Strategjisë së trajnimeve INSTAT si dhe kalendarit vjetor të trajnimeve, janë realizuar trajnimeve të vazhdueshme si brënda dhe jashtë vendit, me qëllim ngritjen, përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale të përditësuar

Gjithashtu, për përmirësimin e vazhdueshëm të punës dhe informatizimin e informacionit për Burimet Njerëzore, gjatë vitit 2019, ka filluar implementimi online i sistemit të rekrutimeve për shërbimin civil në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në faqen eeb: www.rekrutime.instat.gov.al. Ky modul ka ndihmuar në përmirësimin e proceseve të punës të këtij sektori.

Aktivitete të realizuara për vitin 2019

Në organikën e re të INSTAT, e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me nr. 127/2018 datë 29.12.2018, numri i punonjësve të miratuar është 236 punonjës (186 punonjës në qender dhe 50 punonjës në zyrat rajonale).

Pas miratimit të organikës së re, gjatë muajve Janar-Shkurt 2019 është kryer procesi i ristrukturimit të institucionit.

Bazuar në ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” Drejtoria e Financës dhe Projekteve ka në përgjegjësinë e saj detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë Përgjegjëse për të kryer procedurat e rekrutimit referuar Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2019, Njësia përgjegjëse në INSTAT në zbatim të Ligjit nr.152/2013 “Ligji për Nëpunësin Civil”, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij mbi proceset e rekrutimeve, është angazhuar me zhvillimin e procedurave të rekrutimeve për punonjës të strukturës, pjesë e shërbimit civil, për plotësimin e pozicioneve vakante të institucionit.

Si dhe në vitet e mëparshme stafi INSTAT-it përbëhet kryesisht nga gjinia femërore. Përqindja e vendit që zënë femrat është 68% kundrejt meshkujve me 32 %.

Rekrutime. Njësia Përgjegjëse në INSTAT gjatë vitit 2019 ka përfunduar procedurat e rekrutimeve sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin civil” për 62 punonjës.

Praktikantët. Në kuadër të “Programit Kombëtar të Praktikave të punës për vitin 2019”, INSTAT ka përzgjedhur dhe kanë përfunduar me sukses 4 praktikantë.

Në përfundim të periudhës 3-mujore të praktikës në kuadër të këtij programi janë kontraktuar me kontratë 1-vjecare - 2 Specialist Praktikantë.

Punonjës me kontratë afatgjatë dhe me kontratë afatshkurtër. Gjatë vitit 2019 janë kontraktuar 309 punonjës me kontratë afatgjatë në pozicionet kontrollor, kontrollor anketimi, operator dhe anketues. Numri i punonjësve me kontratë afatshkurtër ka qënë 870 të punësuar në pozicionet , anketues me kontratë të përkohshme në pozicionet sipas anketave, anketues, operatorë dhe kontrollorë ankete.

Trajnimet e stafit.

Gjatë vitit 2019 janë trajnuar gjithësej 11 punonjës në trajnime afatgjata në kuadër të programeve të BE-së dhe Eurostat IPA me shumë përfitues, si dhe 79 punonjës në trajnime të tjera 3-4 ditore.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019, Instituti i Statistikave, në zbatim të ligjit 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” si dhe të “Strategjisë së Trajnimeve, 2018”, ka zhvilluar një sërë trajnimesh (7 në total) për punonjësit e INSTAT, ku janë trajnuar 101 punonjës.

Gjatë vitit 2019, gjithashtu janë kryer një sërë trajnimesh me tema të cilat përfshijnë kategori të ndryshme njohurish dhe specilastësh apo drejtuesish nga Shkolla e Administratës Publike, ku janë trajnuar gjithsej 71 punonjës (47 trajnime 1-3 ditore, dhe 24-trajnim të detyrueshëm për shërbimin civil).

Figura 8: Rekrutimet nga Njësia Përgjegjëse





Figura 9: Numri i punonjësve në raportin Femra/Meshkuj



Burimet Financiare

Aktivitetetë realizuara për vitin 2019

INSTAT është institucionin publik qendror, i pavarur. Burimet e financimit për kryerjen e aktiviteteve statistikore dhe atyre mbështetëse sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Ndikim

domethënës kanë edhe financimet e huaja nëpërmjet donatorëve apo granteve të alokuara nga ata, si dhe të ardhurat dytësore apo fondet jashtë limitit, të cilat sigurohen nga veprimtaritë dytësore që kryen INSTAT.

Për vitin 2019 janë shpenzuar nga buxheti i shtetit rreth 596 milion lekë, së bashku me donatorët janë shpenzuar 789 milion lekë sipas tabelës së më poshtme:

Tabela 20: Shpenzimet


000/leke

Ar	SHPENZIMET	FAKT						
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
	Paga + kontribut	231,328	278,819	280,366	274,469	349,893	396,913	466,709
	Mallra dhe shërbime të tjera	59,071	60,091	57,575	58,318	67,427	62,330	79,441
	Totali operative	290,398	338,910	337,941	332,787	417,320	459,243	546,149
	Investime	2,997	6,928	6,401	11,599	18,902	27,560	28,994
	Totali Buxheti	293,396	345,838	344,342	344,386	436,222	486,803	575,144
	Paga + kontribut	12,942	14,055	6,518	6,539	11,526	9,500	19,135
	Mallra dhe shërbime të tjera	103	44	7,954	10,254	17,980	19,853	1,993
	Totali operative	13,045	14,099	14,472	16,793	29,506	29,353	21,128
	Investime	0	0	0	0	0	0	0
	Totali nga të ardhurat	13,045	14,099	14,472	16,793	29,506	29,353	21,128
	Paga + kontribut	1,146	527	869	3,515	1,313	2,080	962
	Mallra dhe shërbime të tjera	11,610	4,949	4,620	950	18,453	21,009	25,219
	Totali operative	12,756	5,476	5,489	4,466	19,766	23,089	26,182
	Investime	328					2,366	1,920
	Të ardhura jashtë limiti	13,084	5,476	5,489	4,466	19,766	25,455	28,102
	Paga + kontribut	8,514	4,558	723	1,430	1,746	3,666	23,262
	Mallra dhe shërbime	61,143	98,905	15,883	606	3,950	9,162	96,209

	te tjera							
	Totali operative	69,657	103,463	16,606	2,036	5,696	12,828	119,471
	Investime	400		2,769		25,775	5,879	45,049
	Te ardhura donator	70,057	103,463	19,375	2,036	31,471	18,707	164,520
	Paga + kontribut	253,930	297,959	288,476	285,953	364,477	412,159	510,068
	Mallra dhe shërbime te tjera	131,926	163,989	86,032	70,128	107,810	112,355	202,862
	Totali operative	385,856	461,948	374,508	356,081	472,287	524,513	712,930
	Investime	3,725	6,928	9,170	11,599	44,677	35,805	75,963
	TOTALI	389,581	468,876	383,678	367,680	516,964	560,318	788,893

000/leke

Figura 10: Shpërndarja e shpenzimeve operative dhe investimeve në vitet 2013-2019 me fondet e buxhetit të shtetit paraqitet si më poshtë:



Siç shihet nga grafiku volumin kryesor të shpenzimeve në vite e zë pjesa e pagave të stafit të INSTAT-it dhe ajo e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme.

Ndërkohë, për vitin 2019 ka patur një rritje në zërin paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore si rezultat i zbatimit të Ligjit Nr.17, datë 05.04.2018, "Për Statistikat zyrtare", sipas të cilit struktura organizative e INSTAT-it miratohet me vendim të Kuvendit dhe ka ndryshuar kategorizimi i pagave.

Instituti të Statistikave për vitin ushtrimor 2019 i janë akorduar nga buxheti i shtetit 662,940 mijë lekë nga 530,445 mijë lekë të akorduara në vitin 2018, ose më shumë 132,495 mijë lekë.

Për periudhën janar- dhjetor 2019 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 596,272 mijë lekë .

Realizimi i shpenzimeve të Aparatit Qëndror INSTAT dhe Zyrave të Statistikave në rrethe, sipas zërave

Tabela 21: Realizimi i shpenzimeve Janar - Dhjetor 2019

mije /leke

Art	SHPENZIMET	VITI 2019			REAL Vjetor %
		PL Vjetor	PL I rish	Fakt 2019	
600	Paga	379,000.0	459,000.0	416,524.0	90.7
	Zyrat Rajonale	34,276.0	35,288.0	31,270.0	88.6
	Aparati Qendror nga buxheti	334,224.0	407,212.0	368,754.0	90.6
	Aparati Qendror nga te ardhurat	10,500.0	16,500.0	16,500.0	100.0
601	Kontribute sig shoq-shend	72,350.0	78,350.0	69,320.0	88.5
	Zyrat Rajonale	5,740.0	5,923.0	5,232.0	88.3
	Aparati Qendror nga buxheti	64,860.0	69,677.0	61,453.0	88.2
	Aparati Qendror nga te ardhurat	1,750.0	2,750.0	2,635.0	95.8
602	Mallra dhe shërbime të tjera	178,416.0	92,416.0	80,367.0	87.0
	Zyrat Rajonale	5,120.0	5,290.0	4,881.0	92.3
	Aparati Qendror nga buxheti	171,296.0	85,126.0	73,493.0	86.3
	Aparati Qendror nga te ardhurat	2,000.0	2,000.0	1,993.0	99.7
604	Transferime korente	1,574.0	1,574.0	472.0	30.0
	Aparati Qendror nga buxheti	1,574.0	1,574.0	472.0	30.0
606	Transferime buxhetesh familjare		600.0	595.0	99.2
	SHUMA	631,340.0	631,940.0	567,278.0	89.8
	Investime Aparati Qendror	26,000.0	31,000.0	28,994.0	93.5
230	Shpenz për rritjen e AQ të patr Buxheti				
231	Shpenz për rritjen e AQ të trup Buxheti	26,000.0	31,000.0	28,994.0	93.5
	TOTALI	657,340.0	662,940.0	596,272.0	89.9

Siç shihet nga pasqyra, në artikullin 600, paga (që zë rreth 70 % të buxhetit) janë shpenzuar 416,523, mijë lekë e barabartë kjo me 90.7 % krahasuar me planin vjetor .

Ky mos realizim ka ardhur si rezultat i mos plotesimit mesatarisht të 30 vendeve vakante të organikës .

Në artikullin sigurime shoqërore e shëndetsore janë shpenzuar 69.319 mijë lekë, e barabartë kjo me 88.5 % krahasuar me planin vjetor. Ky mos realizim ka ardhur si rezultat i mos realizimit të fondit te pagave .

Në zërin mallra dhe shërbime të tjera, për vitin 2019 janë shpenzuar 80.367 mijë lekë, e barabartë kjo me 87.1 %, krahasuar me planin vjetor.

Në zërin transferime korente, për vitin 2019 janë shpenzuar 472 mijë lekë, e barabartë kjo me 30 %.

Në zërin transferime buxhetesh, për vitin 2019 janë shpenzuar 595 mijë lekë, e barabartë kjo me 94.5 %.

Në zërin investimet janë shpenzuar 28.944 mijë lekë ose 93.5 % e krahasuar me planin vjetor. Këto fonde INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistikore”.

Tabela 22: Buxheti sipas programit “Veprimtaria Statistikore”

Mijë/lekë


SHPENZIMET	Plani	Fakti	% Realizimit
Veprimtaria Statistikore	662,940	596,272	89.9 %
Të ardhura jasht limitit	28,102	28,102	100 %
TOTALI	691,042	624,374	90.4 %

Tabela 23: Realizimi i shpenzimeve Janar – Dhjetor 2019

Mijë/lekë

Art	SHPENZIMET	VITI 2019		
		PL.Vjetor	Fakt 2019	R.Vjetor ne %
600	Paga+sig	537,350	485,844	90.4
602	Mallra dhe sherbime te tjera	94,590	81,434	86.1
	Shuma operative	631,940	567,278	89.8
602	Shpenz per rritjen e AQ te trup Buxheti	31,000	28,994	93.5
	SHUMA	662,940	596,272	89.9

Figura 11: Shpenzimet 2019



Siç shihet nga të dhënat e tabelës, plani i shpenzimeve të buxhetit në artikullin 600+601 (paga dhe sigurime) që zë rreth 81 % të tij është realizuar 90.4 %, në artikullin 602 shpenzime të tjera korrente që zë 14 % të buxhetit është realizuar 87.1% dhe në artikullin 231 shpenzime për investime që zë 5 % të buxhetit është realizuar 93.1% . Shpenzimet totale janë realizuar 89.9. % në krahasim me planin vjetor.

Zbatimi i rekomandimeve

Zbatimi i Rekomandimeve të Kuvendit

Kuvendi i Shqipërisë, me Rezolutën nr. 2, datë 16.05.2019 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2018”, përveç vlerësimit të arritjeve në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, përgatitjes së strategjisë së Censit të ardhshëm të Popullsisë e Banesave, angazhimit në ngritjen e Qendrës së Trajnimit Statistikor, forcimit të bashkëpunimit me institucionet dhe aktorët e tjerë apo progresit të bërë në fushat statistikore me fokus përputhshmërinë me standardet evropiane, i ka kërkuar INSTAT-it që gjatë vitit 2019 të fokusohet edhe në drejtim të forcimit të kuadrit rregullator, ngritjen e strukturave sipas parashikimeve të ligjit për statistikatat zyrtare, përgatitjen e një strategjie zhvillimore për sistemin statistikor në vend dhe zgjerimin e gamës së statistikave zyrtare. Në vijim një informacion mbi progresin e bërë për secilin rekomandim të rezolutës:

Rekomandimi 1

Të përfundojë pilotimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe të marrë të gjitha masat përgatitore që sigurojnë kryerjen e tij me sukses vitin e ardhshëm, si aktiviteti kryesor dhe më kompleks statistikor që zhvillohet në nivel vendi. Një plan i detajuar për kryerjen e Censit t’i bashkëngjitet planit vjetor 2020 që miratohet në Kuvend.

Statusi: Realizuar

INSTAT ka kryer Pilot Censin në Nëntor të viti 2019.

Një Plan i detajuar i aktiviteteve të Censit është i përgatitur dhe ka shërbyer për kërkimin e financimeve nga buxheti i shtetit dhe mbështetjen e donatorëve. Plani i detajuar do të rishikohet brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2020, pasi të ketë marrë në konsideratë gjetjet e pilotit të censit.

Ndërkohë, projekt-pyetësi dhe data e saktë e censit do t’i dërgohen Kuvendit menjëherë pas miratimit të projektligjit “Për censin e popullsisë dhe banesave” si dhe rivlerësimit të gjetjeve nga piloti i censit.

Rekomandimi 2

Të përditësojë bazën ligjore dhe të bëjë përcaktimet e sakta në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, në çdo material të publikuar nga INSTAT në faqen online ku citohen vendime dhe ligje të shfuqizuara si: Rregullorja e brendshme e INSTAT, Struktura Organizative, Strategjia e Zhvillimit të INSTAT 2017-2030, Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021, etj.

Statusi: Realizuar

INSTAT ka listuar në faqen e tij zyrtare aktet ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucionit dhe Sistemit Kombëtar Statistikor.

<http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/legjislacioni/>

Rekomandimi 3

Të marrë masa që pas konstituimit të mandateve të anëtarëve, Këshilli i Statistikave, të përmbushë me përpikmëri rolin dhe detyrat në përputhje me kërkesat e Ligjit të ri nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare” e të japë kontribut konkret në realizimin sa më të plotë të misionit dhe objektivave të INSTAT.

Statusi: Realizuar

Me vendimet nr. 75 – 81, Këshilli i Ministrave ka miratuar anëtarët e rinj të Këshillit të Statistikave, në mbështetje të VKM nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”. Faqja zyrtare e INSTAT ka një dritare të dedikuar për Këshillin e Statistikave. Aktualisht Këshilli ka zhvilluar 3 mbledhje në mandatin e tij të plotë, ku kryesisht ka shqyrtuar projektdokumentet e propozuara për planifikimin statistikor vjetor, si dhe raportet e ecursisë së veprimtarive statistikore nga Sistemi Kombëtar Statistikor. Këshilli i ri i Statistikave ka miratuar rregulloren e funksionimit të tij dhe ka zgjedhur zëvendëskryetarin e Këshillit.

Rekomandimi 4

Të bëjë publikimin e vendimeve dhe materialeve të miratuara nga Këshilli i Statistikave dhe Bordi Drejtues i INSTAT, në funksion të transparencës dhe informimit, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

Statusi: Realizuar

INSTAT ka hapur dritare të dedikuar për veprimtarinë e Këshillit të Statistikave në linkun:

<http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABshilli-i-statistikave/>

Veprimtaria dhe përbërja e Bordit Drejtues janë publikuar në faqen zyrtare të INSTAT në linkun: <http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/ne-jemi-instat/bordi-drejtues-i-instat/>

Rekomandimi 5

Të përgatisë Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor me synim përmbushjen e detyrimeve të Eurostat për forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe zbatimin e parimeve statistikore evropiane. Strategjia të shoqërohet me një plan konkret veprimi për përmbushjen e saj.

Statusi: Realizuar pjesërisht

Strategjia e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor është përgatitur me ndihmën e ekspertëve të huaj të siguruar nëpërmjet një projekti me Bankën Botërore. Ajo përfshin periudhën 2020-2030, ndërkohë që shoqërohet me projektplanin trevjeçar për zbatimin e saj 2020-2022. Aktualisht dokumenti është finalizuar nga INSTAT dhe dërguar në Këshillin e Ministrave dhe institucione të tjera për mendim.

Gjatë vitit 2019, me përmbajtjen e projekt-dokumentit janë dakordësuar: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Shërbimi Social Shtetëror; Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Shërbimi Gjeologjik Shqiptar; Shërbimi Kombëtar i Punësimit; Prokuroria e Përgjithshme; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

Ndërkohë, Këshilli i Statistikave ka sugjeruar riformatimin e projekt-dokumentit në kuadër të standardizimit të dokumenteve strategjike sektoriale e ndërsektoriale, për nga ana strukturore e dokumentit. Kontakte me strukturat përkatëse pranë Kryeministrit janë zhvilluar në këtë drejtim. Për këtë arsye, gjatë këtij viti INSTAT do ta rishikojë Strategjinë nga ana strukturore, për të qenë në linjë me strategjitë e tjera sektoriale e ndërsektoriale.

Rekomandimi 6

Të vlerësojë statistikatat e prodhuara nga ministratë dhe agjencitë e tjera statistikore dhe, duke marrë parasysh mendimin e Këshillit të Statistikave, të krijojë një listë më të gjerë të statistikave zyrtare duke rritur numrin e të dhënave të transmetuara në Eurostat, si mënyrë për të rritur nivelin e

përputhshmërisë me standardet evropiane. Programi pesëvjeçar duhet të përshtatet për të mbuluar këtë listë më të gjerë të statistikave zyrtare.

Statusi: Realizuar

Zbatimi i rekomandimit është mbështetur nga aktivitetet në kuadër të përgatitjes së projektstrategjisë së zhvillimit të sistemit. Është përgatitur një listë me institucione publike që mund të konsiderohen si prodhues potencialë të statistikave zyrtare, të cilët mund të përfshihen si të tillë pas në Programin e ardhshëm të Statistikave Zyrtare 2022-2026, siç është Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Ndërkohë, projekt-Plani Vjetor 2020 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021, i cili i është dërguar Këshillit të Ministrave për t'ia përcjellë Kuvendit, parashikon një zgjerim të gamës së treguesve për tu prodhuar gjatë këtij viti.

Rekomandimi 7

Të forcojë rolin koordinues dhe komunikimin duke krijuar një Komitet të Prodhuesve të statistikave zyrtare, i cili të sigurojë zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave në të gjithë Sistemin Kombëtar Statistikor.

Statusi: Në proces

Sipas legjislacionit për statistikën zyrtare, aktualisht prodhuesit e statistikave zyrtare janë tre institucione: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë. INSTAT ka planifikuar krijimin e Komitetit të Prodhuesve nëpërmjet një projekt-urdhëri të përbashkët ndërmjet titullarëve të këtyre institucioneve, duke u bazuar në një marrëveshje të përbashkët trepalëshe të nënshkruar në vitin 2016 në interes të zhvillimit të statistikave të llogarive kombëtare. Si anëtarë të komitetit, Banka e Shqipërisë ka caktuar njërin nga Zëvendësguvernatorët, ndërkohë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka caktuar njërin nga zëvendësministrat e kësaj ministrie.

Në muajin Dhjetor 2019, Eurostat i rekomandoi INSTAT-it detyra dhe përgjegjësi konkrete të këtij komiteti, në mënyrë që të përafrohet me instrumentet e të njëjtës natyrë të vendeve të tjera të BE-së. Sugjerimet janë reflektuar në projekt-urdhërin e përbashkët dhe i janë përcjellë për mendim Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Rekomandimi 8

Të propozojë ndryshime ligjore nëse gjykon se çënohet konfidencialiteti statistikor nga legjislacioni dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi, si ligji “Për Arkivat” dhe ligji “Për të Drejtën e Informimit”, për të vendosur një balancë ndërmjet ruajtjes së konfidencialitetit statistikor dhe të drejtës për informim.

Statusi: Realizuar

Me qëllim që të ketë harmonizim në standardet e ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale të mbledhura për qëllime statistikore, INSTAT ka zhvilluar takime në nivele drejtuesish dhe specialistësh me perfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Të dy institucionet kanë dhënë mendimet e tyre respektive. Nga inputet e marra, INSTAT është i mendimit se legjislacioni për arkivat dhe ai për mbrojtjen e të dhënave personale nuk çënojnë respektimin e konfidencialitetit statistikor. Megjithatë, me qëllim që të forcohet mbrojtja e këtij parimi, mbështetur në nenet 17 dhe 20 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare”, me propozimin e Bordit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka nxjerrë udhëzimin përkatës për marrjen e masave dhe monitorimin e zbatimit të konfidencialitetit statistikor.

Rekomandimi 9

Të vijojë përafrimin e legjislacionit shqiptar për statistikatat zyrtare në përputhje me parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe parimet themelore të statistikave të prodhuara nga Kombet e Bashkuara.

Statusi: Plotësuar

Në interes të përafrimit legjislativ, si dhe në kuadër të veprimtarisë përgatitore për hapjen e negociatave, nën cilësinë e udhëheqësit dhe përgjegjësit për Kapitullin 18 “Statistikat” të acquis, INSTAT ka vlerësuar kuadrin ligjor ekzistues për fushën e statistikave, duke përcaktuar nivelin e përputhshmërisë për secilën acquis. Gjithashtu, INSTAT ka hartuar planin e punës në kuadër të PKIE dhe projekt-planin për zbatimin e strategjisë së Sistemit Kombëtar Statistikor.

Aktualisht, akti më i rëndësishëm për përputhshmërinë e standardeve statistikore, është projektligji “Për censin e popullsisë dhe banesave”, i cili pritet të diskutohet dhe miratohet nga Kuvendi.

Rekomandimi 10

Të përmirësojë në vazhdimësi imazhin e institucionit dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikën zyrtare. Të krijojë një sistem të grupeve të përhershme të përdoruesve, për konsultime periodike me synim për t'iu afruar gjithnjë e më tepër pritshmërive të përdoruesve, duke respektuar parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare.

Statusi: Realizuar

Në zbatim të këtij rekomandimi, INSTAT ka krijuar grupe të reja me përdoruesit si dhe ka zgjeruar ata ekzistues, duke ftuar pjesëtarë të tjerë relevant. Aktualisht është në fazën e përgatitjes së një plani takimesh gjatë vitit 2020, takime të cilat do të shërbejnë jo vetëm për përmirësimin e cilësisë statistikore por edhe për kryerjen me sukses të aktivitetit madhor, siç është Censi i popullsisë dhe banesave.

Rekomandimi 11

Të forcojë bashkëpunimin me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja statistikore e rritjes së kapaciteteve profesionale statistikore dhe me median për të rritur ndërgjegjësimin mbi përdorimin e statistikave zyrtare dhe edukuar audiencën për një përdorim e interpretim sa më të mirë të informacionit statistikor.

Statusi: Në proces

Për të rritur bashkëpunimin me botën akademike, INSTAT ka planifikuar të trajtojë studentët përmes praktikave, të përfshijë stafin e INSTAT në mësimdhënie në universitete, të bashkëpunojë për përgatitjen e artikujve shkencorë, dhe të sigurojë akses në të dhëna mikro për qëllime shkencore. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2019 janë nënshkruar memorandume të reja bashkëpunimi me universitete publike dhe private si dhe janë rishikuar marrëveshjet ekzistuese për t'iu përshtatur kërkesave të reja të legjislacionit për statistikën zyrtare.

Në të njëjtën linjë me grupet e përdoruesve, INSTAT po punon për ngritjen e Komitetit me botën akademike. Për këtë qëllim, me kërkesën e INSTAT, universitete të ndryshme publike dhe private kanë caktuar një përfaqësues nga profesorati me qëllim që të diskutohen dhe propozohet teknikat moderne të përpunimit statistikor dhe nevojat e akademikëve për të dhëna.

Gjithashtu, në funksion të rritjes së bashkëpunimit me botën akademike, INSTAT, me mbështetjen e qeverisë suedeze, ka filluar procesin e ngritjes së një sistemi të integruar të të dhënave, i quajtur "SIMONA", i cili do të mundësojë aksesin e të dhënave që disponohen në interes të proceseve kërkimore-shkencore.

Rekomandimi 12

Të paraqesë të njëjtët tregues, si në tabelën e indikatorëve të performancës të paraqitur në çdo plan vjetor të punës të Institucionit ashtu edhe në tabelën e indikatorëve të performancës të paraqitur në çdo raport vjetor, që të ketë mundësi krahasimi me bazë të njëjtë.

Statusi: Realizuar

Për zbatimin e rekomandimit, INSTAT ka vendosur pasqyrën e unifikuar të indikatorëve të performancës PAF në çdo dokument planifikimi dhe raportimi. Impakti i zbatimit do të shikohet në tremujorin e parë të vitit 2020.

Rekomandimi 13

Të zhvillojë kapacitetet profesionale statistikore të punonjësve dhe të masë indikatorët e performancës dhe eficiencës në kryerjen e detyrave e përgjegjësi të ngarkuara, si dhe të kontribuojë në zgjerimin e njohurive statistikore tek statisticienët e agjencive të tjera statistikore.

Statusi: Në proces

Për zhvillimin e kapaciteteve profesionale, INSTAT është në zbatim të Planit vjetor të Trajnimeve, të cilat sigurohen kryesisht me mbështetjen e Eurostat dhe Shkollës së Administratës Publike ASPA. Aktualisht institucioni është në proces të përcaktimit të indikatorëve të performancës së punonjësve, për tu monitoruar gjatë vitit 2020.

Rekomandimi 14

Të intensifikojë marrëdhëniet me institucionet homologe të vendeve anëtare të BE-së dhe Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të përditësohet me metodologjitë dhe praktikat më të mira statistikore të aplikuara si dhe të përfitojë nga eksperiencat e institucioneve respektive

Statusi: Plotësuar

INSTAT ka një bashkëpunim të ngushtë me institucionet ndërkombëtare, veçanërisht Eurostat. Gjatë periudhës së raportimit, përfaqësues të institucionit kanë marrë pjesë në workshope dhe konferenca të cilat kanë të bëjnë kryesisht me standardet e raundit të ri të Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe ato për zhvillimin e infrastrukturës statistikore në fusha të ndryshme.

Shqipëria është përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm në aktivitete ndërkombëre të përvitshme të nivelit të lartë, si Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, ku

INSTAT ka ndarë eksperiencën e Shqipërisë në përgatitjen e Raportit Vullnetar Kombëtar, paraqitur në Forumin e Nivelit të Lartë Politik në muajin Korrik 2018 si dhe rolin dhe përfshirjen e INSTAT në proces.

Gjithashtu INSTAT së fundi është aprovuar nga Konferenca e Statisticienëve Evropianë dhe Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara për të qënë pjese e Grupit të lartë drejtues “Grupi i nivelit të lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ndërtim të Kapaciteteve për Statistikat për Axhendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm”, ku Shqipëria ka firmosur angazhimin për zbatimin e axhendës 2030 dhe ku INSTAT ka botuar dhe do vijojë çdo vit botimin e SDG-ve në Shqipëri.

Në kuadër të zbatimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave, INSTAT ka intensifikuar marrëdhëniet me donatorët për të përfituar mbështetjen e tyre në zëra të ndryshëm të këtij aktiviteti. Në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave të Zvicrës dhe me mbështetjen e qeverisë zvicerane, INSTAT po punon për ngritjen e Regjistrit statistikor të Ndërtesave dhe Banesave, si instrument i domosdoshëm për forcimin e statistikave zyrtare në nivel vendor.

Zbatimi i rekomandimeve të auditeve

Në vitin 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer një auditim pranë Institutit të Statistikave sipas Programit të Auditimit të Performancës për Monitorimin e Projekteve të Huaaja, me nr. prot 1500/2, datë 23.10.2019. Ky auditim është zhvilluar për disa struktura që menaxhojnë projektet e huaaja të cilat financohen nga fondet e BE, përfshirë edhe institucionin tonë.

Rekomandimet e lëna për INSTAT nga grupi auditues janë në total 3. Ato janë pranuar dhe zbatuar nga institucioni gjatë vitit 2019 dhe në vijim, për shkak të natyrës dhe specifikës së rekomandimit të lënë. Në formë më të detajuar, informacioni në vijim:

Rekomandimi 1

Njësia IPA pranë INSTAT, duke kërkuar edhe asistencën e strukturave të tjera të menaxhimit indirekt, të sigurojë trajnim të plotë dhe të përshtatshëm për stafin e përfshirë në implementimin e projekteve të ardhshme IPA, në të cilat institucioni do të jetë përfitues.

Statusi: Plotësuar

Njësia IPA pranë INSTAT, i ka adresuar sektorit të burimeve njerezore të Institucionit nevojat e njësisë për trajnime specifike në lidhje me menaxhimin e fondeve të BE. Gjithashtu bazuar në

Manualin e Procedurave për Njësinë IPA, seksioni C6.1 "Analiza e nevojave për trajnim" Njësia IPA ka dorëzuar pranë CFCU analizën e nevojave për trajnime për vitin 2020.

Rekomandimi 2

Njësia IPA pranë INSTAT, me qëllim përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit në projektet e ardhshme që do të përfitojë, të hartojë dhe të përditësojë vazhdimisht Regjistrin për dobësitë e kontrollit të brendshëm dhe bazën e të dhënave kronologjike të ndryshimeve gjatë projektit.

Statusi: Plotësuar

Njësia IPA pranë INSTAT përditëson rregullisht dhe dorëzon në mënyrë periodike pranë CFCU, rregjistrin e riskut, parregulltësitë dhe dorëzon rregjistrin me rekomandimet e lëna nga agjencia audituese, audit i brendshëm, si dhe vizitat verifikuese që kryen CFCU dhe NAO në INSTAT, të cilat janë mjete për të monitoruar dobësitë e kontrollit të brendshëm. Bazuar në Manualin e Procedurave për Njësinë IPA, seksioni D.1.1 "Kontrolli i brendshëm i dobësive dhe dështimeve" citohet se, nuk kërkohen raportime specifike shtesë të dobësive të kontrollit të brendshëm, pasi procedurat ekzistuese, nëse përdoren në mënyrë korrekte, duhet të jenë të mjaftueshme për raportimin e dobësive të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 3

Njësia IPA pranë INSTAT të jetë e angazhuar me kohë të plotë në detyrat funksionale të lidhura me fondet IPA dhe të mos ngarkohet me detyra të tjera, vecanërisht gjatë kohës që institucioni po zbaton një projekt të financuar me këto фонде.

Statusi: I paplotësuar

Aktualisht, njësia e ngritur brenda strukturës organizative të INSTAT kryen edhe detyra të tjera. Megjithatë, INSTAT do të marrë masa për të patur një Njësi IPA të dedikuar vetëm në përmbushjen e detyrave funksionale të lidhura me fondet IPA.

Informacion mbi konfliktet gjyqësore ku INSTAT është palë

Në vitin 2019 janë hapur 2 çështje të reja gjyqësore. Në njërin prej tyre INSTAT është paditur për anulimin e një akti administrative mbi masën disiplinore "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë". Aktualisht çështja është pranë gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë. Në çështjen tjetër,

INSTAT është thirrur si palë e tretë në çështjen civile me objekt “Rillogaritje e vlerësimit të bërë për kthimin dhe kompensimin e pronës”. Aktualisht çështja është pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në vitin 2019 dy vendime gjyqësore ndaj çështjeve të mbartura kanë marrë formë të prerë. Çështje që vazhdojnë e ndiqen në shkallë të ndryshme të gjyqësorit janë 7, të filluara para vitit 2019, ndërkohë që 11 çështje janë pranë Gjykatës së Lartë si pasojë e rekursit.

Çështjet gjyqësore kanë të bëjnë kryesisht me padi për pavlefshmërinë e vendimeve administrative për ndërprerjen e punës dhe shpërblim dëmi, padi për ekzekutimin e detyrimeve kontraktore dhe kundërshtimin e veprimeve përmbare.

Përsa i takon kallzimeve apo çështjeve penale, nuk janë regjistruar raste të tilla në lidhje me veprimtarinë e institucionit.

Kontaktet e institucionit



INSTAT - Instituti i Statistikave

Instituti i Statistikave - Tiranë

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

Email: info@instat.gov.al

Telefon+(355) 42222411